



The Heritage

Nr. 12/2014



INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

**UNIVERSITETI
NDËRKOMBËTAR
I STRUGËS**



UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS

THE HERITAGE

REVISTË PERIODIKE

Nr.12 / 2014

Editor in Chief: Prof. Dr. Mevlud Dudic

Co-Editor in Chief: MSc. Dorian Leka

d.leka@eust.edu.mk

Editors: PhD. Biljana Ciglovska

b.ciglovska@eust.edu.mk

PhD Candidate, Nazmie Merko – Zabzun

n.merko@eust.edu.mk

Technical Secretary: Msc. Blerti Dauti

b.dauti@eust.edu.mk

Editorial Staff:

Prof. Dr. Sulo Haderi - International University of Tirana, R. Albania

Prof. Dr. Anastas Angjeli - Mediteranean University of Albania

Prof. Dr. Shyqeru Kabashi - Kolegji Biznesi Prishtina, R. Kosovo

Prof. Dr. Enver Duran - Trakya University - R. Turkey

Prof. Dr. Marko Bello - University of Tirana - R. Albania

Prof. Dr. Tony Ogiamien - American Heritage University of Southern California - USA

Prof. Dr. Radoje Radic - University of Banja Luka, Republic of Srpska

Prof. Dr. Suzana Bubic - University of Mostar, R. Sarajevo

Prof. Dr. Jelena Lekic - University of Novi Pazar, R. Serbia

Prof. Dr. Daglas Kapogrosi - Cornell University - USA

Prof. Dr. Joseph Minsfud - Emuni University - R. Slovenia

Prof. Dr. Luan Hajdaraga - University Marin Baleti - Tirana, R. Albania

Prof. Dr. Armen Kadriu - International University of Struga, R. Macedonia

Prof. Dr. Ljupco Stojceski - International University of Struga, R. Macedonia

Prof. Dr. Ljubisha Petrushevski - Euro College - Kumanovo, R. Macedonia

Prof. Dr. Flora S. Kastrati - State University of Tetovo, R. Macedonia

Prof. Dr. Elez Osmani - Mediteranean University of Bar, R. Montenegro

Prof. Dr. Liljana Elmazi - University of Tirana - R. Albania

Prof. Dr. Ligor Nikolla - University of Tirana - R. Albania



ISSN 1857-7482

Botim shkencor i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës

www.eust.edu.mk

www.eust.edu.mk/Heritage/

Nr.12, 2014

TREGUESI I LËNDËS:

STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT	5
TRAKTATET NDËRKOMBËTARE NË PIKËTAKIMIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PUBLIKE ME DEGË TË TJERA TË SË DREJTËS.....	13
KODIKËT E SHQIPËRISË - IMPRESIONE VIZIVE -ESTETIKA DHE ETIKA E PËRSOSUR E TYRE	25
HOW TO AVOID THE STRATEGIC IMPLICATIONS OF MISUSE OF SPECIAL FORCES IN THE STABILITY OPERATIONS AND ITS CONSEQUENCES FOR HIGH POLITICS OF EACH NATO COUNTRY.....	38
NGRITJA DHE RËNIA E REFORMËS AGRARE.....	54
ZHVILLIMI, NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I LIGJIT PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE NGA PERIUDHA 1982 DERI MË VITIN 2013.....	66
TEKNOLOGJIA E LËVIZSHME (MOBILE)- NJË ZGJIDHJE PËR TURISTËT E DITËVE TË SOTME.....	85
ПРАВСУДНИ НАЧИНИ НА РЕШАВАЊЕ МЕЃУНАРОДНИ СПОРОВИ.....	97
ПРЕГОВАРАЧКИОТ ПРОЦЕС ВО ИЗРАЕЛСКО-ПАЛЕСТИНСКИОТ КОНФЛИКТ	130
INTEGRIMI I FËMIJËVE EMIGRANTË NË SHKOLLAT PUBLIKE NJË SFIDË E HAPUR PËR SHOQËRINË EUROPIANE	148

Prof. Dr. Gëzim Selimi

Drejtor i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, Dega
Gostivar. Profesor dhe botues i disa literaturave universitare
në shërbim të Shkencave Ekonomike.

STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT

PËRMBLEDHJE

Zhvillimit të kontabilitetit në përgjithësi i kanë paraprirë shumë faktorë dhe si më të rëndësishëm do të theksojmë: përhapjen e arsimimit, përdorimin gjithnjë e më të madh të parave, zhvillimin e subjektit ekonomik me ortakëri, zhvillimin e sistemit kreditues, zhvillimi i tregtisë, ekspansionin më të madh të kapitalit, etj. Me zhvillimin e ekonomisë në shtetet e Evropës qendrore dhe perëndimore nënkuptohet edhe ç'vendosja e zhvillimit të kontabilitetit tek ato shtete. Kështu në Francë është sjellë Code de Commerce, i cili përveç tjerash i ka paraparë përgatitjes së bilancit të gjendjes në çdo dy vjet. Zhvillimi i shpejtë industrial në fillim të shek. XX ka imponuar ndryshime të mëtejshme në praktikën kontabël.

Organizimi i afarizmit modern në subjektin ekonomik, përveç tjerash, ka imponuar forma të reja të revizionit dhe përgatitjes së pasqyrave financiare për publikun. Zgjerimi i rolit të bursave, rregulativës në lidhje me punën e aksioneve, përveç të tjerave, nënkupton një komplikim më të madh në praktikën kontabël. Ndikim veçanërisht të madh në zhvillimin e kontabilitetit kanë kompanitë shumëkombëshe (KSHK). Rritja tepër e madhe e numrit të KSHK konsiderohet paraqitëse e faktorit kryesor të zhvillimit të biznesit ndërkombëtar si dhe të tregtisë ndërkombëtare. Këtu duhet theksuar edhe fakti që të gjitha vendet e botës e kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në tregtinë botërore.

Këmbimi ndërkombëtar ka edhe aspektet e saja kontabël. Çdo eksport apo import i mallrave dhe shërbimeve çon nga një lloj i ndërkombëtarizimit dhe njohjes së shumëfishtë të praktikës së kontabilitetit. Angazhimi gjithnjë e më i madh në këmbimin ndërkombëtar nënkupton rritjen e aktiviteteve ndërkombëtare kontabël dhe shfrytëzimin e ekspertizave të jashtme. Me

themelimin e filialeve në vende të ndryshme, kontabiliteti në rastet e tilla duhet të përballojë kërkesat që dalin nga ligjet dhe rregullat e vendeve të ndryshme, tek të cilat, praktika kontabël dallon në masë të madhe në çdo vend. Kjo do të thotë se duhet të përpilohen PF sipas formave të caktuara tek vendet ku janë të lokuara filialet e KSHK. Ata duhet të përpilojnë gjithashtu pasqyra financiare sipas ligjeve dhe standardeve kontabël të vendit amë të KSHK, që të mund të kryhet konsolidimi i tyre. Kjo, praktikisht, nënkupton shndërrimin e njësive të ndryshme monetare në transaksione eksportuese importuese në kuadër të vendeve të ndryshme në një valutë të përbashkët.

Në sistemin kontabël, siç u theksua më lart ndikojnë edhe faktorë të mjedisit siç janë: sistemi politik, sistemi juridik, sistemi tatimor, politika sociale, sistemi financiar dhe tregu i kapitalit, sistemi monetar, sistemi i ligjeve të kontabilitetit, ligjet mbi pronësinë e subjektit ekonomik, ndikimi i aktivitetit të subjektit ekonomik, vetitë kulturore të një kombi, zhvillimi ekonomik i vendit, sistemi edukativ kontabël, profesioni kontabël, faktorët ndërkombëtar, etj

Vazhdimisht rritet numri i vendeve që kyçen në organizata regjionale dhe organizata ndërkombëtare të kontabilitetit, dhe njëherit rritet edhe numri i vendeve që anëtarësohen në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Për një harmonizim të përgjithshëm të kontabilitetit, sot nuk janë të interesuara vetëm subjektet ekonomike, por edhe institucionet shtetërore. Zvogëlimi i dallimeve në pasqyrimin e raporteve financiare i nxit tendencat e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Prej kohësh është konstatuar se unifikimi i praktikës kontabël e lehtëson dhe e shpejton këmbimin ndërkombëtar të mallrave, kapitalit, dijës dhe njerëzve.

HYRJE

Standardet e kontabilitetit janë deklarata të besueshme dhe udhëzime të kontabilitetit, të ndërtuara mbi bazën e parimeve kontabël ndërkombëtare që paraqesin rregullat se si duhet të njihen, vlerësohen, paraqiten dhe shpjegojnë llojet e veçanta të veprimeve dhe ngjarje të tjera në pasqyrat financiare. Standardet e kontabilitetit janë baza për ndërtimin e pasqyrave financiare që subjekti i publikon për përdoruesit e jashtëm.¹ Në përgjithësi standardet japin udhëzimet dhe rregullat e përpilimit të një pasqyre financiare e cila publikohet zyrtarisht. Standardet që kanë fuqi vepruese në

¹ Sotiraj M. Dharmo, Parimet bazë të kontabilitetit, Tiranë 2010, faq.81.

një vend quhen standarde kombëtare, ndërsa ato që kanë fuqi vepruese në nivel ndërkombëtar quhen standarde ndërkombëtare të kontabilitetit.

1. Kërkesat më kryesore që parashtrohen në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit përmbajnë udhëzime të rëndësishme për raportimin financiar të subjekteve afariste në suaza kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo mund të konstatohet lehtë nëse e kemi parasysh kërkesën që parashtron Komiteti ndërkombëtar në lidhje me përmbajtjen e PF. Ndër treguesit kryesor që kanë rëndësi ndërkombëtare duhen theksuar edhe këto kërkesa:

- Kërkesa për raporte financiare të konsoliduara, bilanci i gjendjes, bilanci i suksesit, pasqyra e flukseve (rrjedhave) monetare dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital.
- Kërkesa për llogaritje në mënyrë adekuate, matje dhe prezantim të: stoqeve, amortizimit, patundshmëritë, pajimet, të ardhurat, shpenzimet në lidhje me kërkimin dhe zhvillimin, shpenzimet për sigurimin pensional, shpenzimet e huamarrjes, investimet, tatimi mbi fitimin, etj.
- SNK vendosin kërkesa për mënyrën e prezantimit të zërave në bilancin e gjendjes, në bilancin e suksesit, zërat që i prezantojnë detyrimet e paparashikuara, transaksionet që ndodhin pas përpilimit të bilancit përfundimtar, etj.
- Kërkesa për informim në lidhje me bashkimin apo blerjen e subjektit ekonomik, investime në filiale, pjesëmarrje në investime të përbashkëta, etj.
- Kërkesa për informim financiar nga bankat dhe institucionet e tjera financiare, informim financiar në kushtet e ekonomisë hiperinflatore, informim në lidhje me planet e pensioneve, etj.

Bordi i Komitetit të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është autoriteti përgjegjës për të vendosur, se cilat standarde të kontabilitetit duhet të përdoren për raportimin financiar në territoret përkatëse, për t'i mbrojtur në mënyrë më efikase investitorët, integritetin e tregut dhe kapitalin.

Edhe përkundër angazhimit të madh të një numri të caktuar ekspertësh të kontabilitetit, financave dhe fushave tjera që prej dekadash japin kontributin e tyre që të përfshijnë sa më shumë elemente të

rëndësishme në raportet financiare, përsëri mbeten disa pyetje që fusha tematike të kompletohet. Kjo ngel detyrë e Komitetit në periudhën e ardhshme kohore.

2. Organet për përgatitjen dhe sjelljen e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Procedura gjatë sjelljes së SNK organizativisht është e vendosur në mënyrë që të sigurojë kualitet të lartë të përbërjes konceptuale, kyçje të zgjidhjeve bashkëkohore kontabël dhe thjeshtësi në trajtimin e praktikës kontabël. Në lidhje me procedurën për sjelljen e SNK, është i ngarkuar Komiteti i cili çdo herë duhet ta ketë parasysh detyrën, që standardet të jenë të formuluar në atë mënyrë që të pranohen nga një numër sa më i madh i vendeve të botës.

Gjatë sjelljes së standardeve në Komitetin për SNK marrin pjesë në mënyrë aktive:

1. Bordi i Komitetit për SNK, i obliguar të udhëheqë me Komitetin për SNK,
2. Grupi këshillues (konsultativ) i cili përcaktohet nga Bordi i komitetit për SNK,.
3. Këshilli këshillëdhënës dhe
4. Komiteti drejtues,

Procedura për sjelljen e SNK

Procedura e nevojshme dhe e detyrueshme për sjelljen e SNK kryhet në gjashtë faza:

- 1). Bordi së pari përcakton Komitetin drejtues i cili duhet të inicion sjelljen e standardit të caktuar apo rishikimin e ndonjë standardi të sjellë më parë.
- 2). Komiteti drejtues nga mësimet e përgjithshme dhe të kërkesave të praktikës bashkëkohore, duke konsultuar ekspertiza profesionale dhe sugjerime të autoriteteve profesionale sjell dhe ia paraqet planin ideor Bordit në lidhje me ndonjë standard.
- 3). Pasi i pranon vërejtjet mbi planin ideor nga ana e Bordit, pas rishikimit të tyre, Komiteti drejtues shpall “draft raportin për parimet”. Qëllimi i

këtij drafti është shërbimi gjatë formulimit të bazave për përgatitjen e ndonjë “draft standardi” të caktuar.

- 4). Komiteti drejtues i analizon vërejtjet e “draft raportit për parimet” dhe harmonizon një raport final për parimet, i cili i dërgohet Bordit për aprovim dhe shërben si bazë për draft standardin, i propozuar për SNK.
- 5). Komiteti drejtues përgatit “draft standardin” për miratim nga ana e Bordit. Pas verifikimit dhe aprovimit të tij nga së paku 2/3 e anëtarëve të Bordit, draft standardi publikohet.
- 6). Komiteti drejtues i analizon vërejtjet dhe përgatit “Draft” të SNK nga ana e Bordit. Pas kontrollit të kryer dhe aprovimit nga ana e $\frac{3}{4}$ e përfaqësuesve, standardi aprovet.

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit mund të ndryshojë ose të tërheqë SNK.

3. Qëllimet, konceptet dhe parimet e përgjithshme të SNK

Standardet e kontabilitetit kanë si qëllim të përgjithshëm të tyre të lehtësojnë krahasimin e raporteve financiare që i përgatisin dhe i publikojnë subjektet ekonomike brenda një vendi apo në suaza ndërkombëtare. Pa këto standarde, krahasimi i pasqyrave do të ishte i pamundur apo tepër i vështirë, për shkak të praktikave të ndryshme në vendet e ndryshme.

Duke filluar që nga viti 1989 Komiteti për SNK vepron në bazë të kornizës së caktuar konceptuale për përgatitjen dhe prezantimin e raporteve financiare. Kjo kornizë përfshin:

- 1). Shfrytëzuesit e raporteve financiare dhe nevojat e tyre për informim,
- 2). Qëllimet e raporteve financiare,
- 3). Supozimet themelore (transaksionet e ndodhura faktikisht, vijueshmëria) të cilat shfrytëzohen gjatë përgatitjes së raporteve financiare,
- 4). Karakteristikat cilësore që i bëjnë informatat të dobishme dhe të shfrytëzueshme për shfrytëzuesit janë qartësia, relevanca, saktësia dhe krahasueshmëria;

- 5). Elementet që në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të kyçura në raportet financiare: mjetet, detyrimet dhe kapitali vetanak, fitimi, të ardhurat dhe të dalurat;
- 6). Kriteret për njohjen e zërave në bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit;
- 7). Baza të ndryshme për matjen e vlerave sipas të cilave elementet pranohen apo njihen në raportet financiare;
- 8). Koncepti i kapitalit dhe mbajtja e kapitalit (në mënyrë vlerore dhe faktike).

4. Parimet mbi të cilat mbështeten SNK

Parimet kontabël, konventat dhe rregullat që i ka sjellë Bordi i SNK janë bërë të pranueshme dhe më të përdorshme se sa parimet e shumë autorëve të tjerë. Ato kanë fituar autoritet dhe e zgjerojnë popullaritetin e tyre vazhdimisht, për shkak të bazës solide në teori, të qartësisë dhe pa mëdyshje nga saktësia në prezantimin e tyre. Për t'u konsideruar i dobishëm në marrjen e vendimeve, informacioni i dhënë përmes zbatimit të standardeve të kontabilitetit duhet të jetë, të paktën: përkatës, i besueshëm, i kuptueshëm dhe i krahasueshëm.

Përkatës: Informacioni financiar duhet të ketë lidhje (përkatësi) me vendimin që po vlerësohet.

I besueshëm: Informacioni duhet të jetë i besueshëm në mënyrë që të japë një përfaqësim besnik të ngjarjeve të cilat kërkon të raportojë.

I kuptueshëm: informacioni duhet të zhvillohet dhe të paraqitet në mënyrë të atillë që, me një punë të arsyeshme, të mund të kuptohet dhe të përshtatet nga përdoruesit në proceset vendimmarrëse të tyre.

I krahasueshëm: Informacioni financiar duhet të përgatitet dhe të paraqitet me konsekuencë të mjaftueshme për të mundësuar krahasimin e ecurisë së subjektit raportues midis periudhave të ndryshme si dhe kundrejt subjekteve të tjera raportuese.

SNK në vete përmbajnë udhëzime për mënyrën e prezantimit dhe raportimit të pasqyrave financiare si në nivel kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar. SNK lehtësojnë komunikimin në mes subjekteve ekonomike

të vendeve të ndryshme, gjë që e rit bashkëpunimin ekonomik të tyre nëpërmjet rritjes së eksportit dhe importit, investimeve të përbashkëta, investimeve të huaja, etj. Direktiva e IV dhe e VII e Unionit European si qëllim kryesor kanë mbrojtjen e investitorëve. Ky synim nuk realizohet vetëm me definimin s SNK-ve, por edhe përmes përcaktimit të rregullave të përgjithshme me të cilat do të harmonizohen konceptet kryesore të kontabilitetit. Në korelacion të njëjtë Parlamenti European ka sjellë Dekret në të cilën të gjitha subjektet që kotojnë në tregjet financiare të UE gjatë përpilimit të raporteve financiare obligohen në përdorimin e SNK-ve. GAAP, janë standarde të gjithëpranueshme në SHBA të cilat kanë përdorim dhe aplikim të gjërë gjatë përpilimit të PF dhe kanë kontribuar në mundësinë e krahasimit të PF në shtetet që i përdorin ato.

Përdorimi i SNK ka përparësitë dhe mangësitë e saja të cilat do ti paraqesim si më poshtë:

Përparësitë	Mangësitë
-Krahasimi i raporteve -Unifikimi i “rregullave të lojës” -Transparenca -Përcjellja më e lehtë e biznesit ndërkombëtar -Ndikon në lidhshmërinë e tregut dhe investimeve të huaja -“Fshin” kufijtë midis vendeve të ndryshme -Lehtëson dhe përshpejton sjelljen e vendimeve të investitorëve, kreditorëve, etj	-Vështërsi në ndërtimin dhe unifikimin e rregullave në regullativën kontabël, -Zgjedhje “tepër të thjeshta” për situata të ndryshme -Çështja e fleksibilitetit të standardeve në specifikat e vendeve të ndryshme në kontekstin e mjedisit ekonomik, politikës tatimore -Dyfish i punëve të kontabilitetit, pranimi i SNK dhe aplikimi i akteve tjera kombëtare -Ndryshime dhe plotësime të vazhdueshme -Çështja e interpretimit të standardeve -Shpenzimet -Shpesh detyrohen për zbatim të gjitha subjektet e disa vendeve, pavarësisht nga madhësia e tyre -Ndryshimi i kulturës së kontabilitetit në disa vende.

PËRFUNDIM

Nga fakti se në Republikën e Maqedonisë përdoren tërësisht (plotësisht) SNK dhe ato janë shpallur njëherit si standarde kombëtare dhe të

njejtat do të vlejnjë tek ne parashtron nevojën që edhe më tepër të sqarohen dhe përdoren ato.

Në interes të publikut është që të formulohen dhe publikohen standardet kontabël që do të respektohen gjatë pasqyrimin të raporteve financiare dhe një herit do ta zgjërojnë njohjen e respektin e tyre në suaza botërore. SNK e lehtësojnë dhe njëherit edhe e thjeshtëzojnë leximin dhe kuptimin e pasqyrave themelore kontabël në nivel ndërkombëtar. Pasqyrat e tilla e bëjnë të mundur krahasimin e pasqyrave të tilla në kuadër të të njejtës degë afariste si dhe në kuadër të vendit apo në kuadër të nivelit ndërkombëtar.

Menaxhmenti i subjektit ekonomik, për nevojat e veta interne, mund të përpiloj pasqyra të ndryshme financiare, sipas metodave të ndryshme, në bazë të nevojës së vendimmarësve të subjektit ekonomik. Por, kur pasqyrat financiare përpilohen për përdoruesit e jashtëm ato duhet të përpilohen vetëm në bazë të SNK. Menaxhmenti i subjektit ekonomik është përgjegjës për përpilimin e pasqyrave financiare dhe për publikimin e tyre adekuat.

LITERATURA:

Etem Dr. Iseni, Cikël leksionesh të kursit kontabiliteti financiar, Tetovë 2010,

Fitim Deari, Parimet e kontabilitetit financiar, Tetovë 2007,

Gëzim Dr. Selimi, Kontabiliteti financiar, Shkup 2013,

Rustem Dr. Asllanaj, Kontabiliteti financiar, Prishtinë 2010,

Sotiraq Dr, Dhano, Kontabiliteti financiar, Tiranë,

International Accounting Standards Committetee, Megjunarodni Smetkovodstveni Standardi 1999, Shkup 1999

Prof. Ass. Dr. Marko Bello

TRAKTATET NDËRKOMBËTARE NË PIKËTAKIMIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE PUBLIKE ME DEGË TË TJERA TË SË DREJTËS

Abstrakt

Traktatet ndërkombëtare përbëjnë pa dyshim formën më të saktë të shprehjes së shtetit në arenën ndërkombëtare. Marrëdhëniet më të rëndësishme midis shteteve, përfshirë dhe ato me të cilat njihet vetë ekzistenca e shtetit, respektivisht zhdukja e tyre, sanksionohen përmes traktateve dhe marrëveshjeve që lidhen midis palëve për këtë qëllim.

Autorë të ndryshëm, ndër të cilët edhe diplomati i shquar rumun i periudhës midis dy luftërave botërore, Nikolae Titulesku, kanë konstatuar një lidhje organike midis kontratës së brendshme dhe traktatit ndërkombëtar. Në këtë kuptim, Titulesku, i cili kishte ligjëruar teorinë e përgjithshme të kontratave në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Bukureshtit, ishte përpjekur që ta gjente përgjigjen, përmes pyetjes retorike: "E çfarë është tjetër traktati ndërkombëtar, përveçse një kontratë në të drejtën e brendshme, me subjekte ndërkombëtare?"

Vlen të theksohet se elementin themelor në rastin tonë e përbën substanca e vullnetit juridik që gjendet i inkorporuar në të dy aktet juridike. Me të vërtetë, pajtimi i vullnetit në të drejtë, haset në të gjitha aktet e vullnetit të njëanshëm, tek aktet dypalëshe apo shumëpalëshe të natyrës civile, në mjaft prej akteve të së drejtës së punës, tek aktet e së drejtës së familjes që kanë të bëjnë me lidhjen e martesës ose tek aktet e tjera që i takojnë marrëdhënieve në familje ose që lidhen me të, madje edhe tek aktet e së drejtës administrative ku vullnetet janë të ndërruar, për sa kohë që vullneti i autoritetit administrativ shprehet përmes karakterit urdhërues kundrejt subjekteve të ndërruar. Për më tepër, në sistemin e përgatitjes së

akteve legislative, vullneti i shtetit është realisht i detyrueshëm, pasi ai duhet inkorporuar në ligj.

I njëjti fenomen ndodh edhe me aktet juridike ndërkombëtare, ku subjekte janë shtetet ndërmjet tyre, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare apo organizatat ndërkombëtare me njera-tjetrën. Pikërisht ky është konteksti, të cilit i referohet Nikolae Titulesku, atëhere kur fiksonte, në planin e teorisë së përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare publike, lidhjen organike ndërmjet kontratës dhe traktatit.

Duke qënë instrumente juridike, me të cilat vendosen relatat midis shteteve të ndryshme, traktatet shfaqen si barometër i stadit të marrëdhënieve të bashkëpunimit midis shteteve, sepse shumëfishimi i raporteve konvencionale ndërmjet shteteve është pazgjidhshmërisht i lidhur me zhvillimin gjithnjë e më të madh të bashkëpunimit ndërkombëtar. Kështu shpjegohet fakti se përse traktatet kanë fituar aktualisht një rëndësi të dorës së parë në dinamizimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe subjekteve të tjera të komunitetit ndërkombëtar.

Tashmë pranohet gjerësisht se midis të drejtës private në përgjithësi dhe të drejtës civile në veçanti, nga njera anë, dhe të drejtës ndërkombëtare publike të traktateve, nga ana tjetër, ekziston një lidhje e pazgjidhshme, pasi konsensusi ndërkombëtar edhe këtu shfaqet si një zgjatim i pajtimit të vullnetit në të drejtën e brendshme të kontratave.

I.Traktatet ndërkombëtare në përgjithësi¹

Zakonisht, termi traktat përdoret në rastin e çdo marrëveshjeje të përfunduar midis entiteteve politike, që nga pikëpamja ndërkombëtare, kanë cilësinë e shtetit apo janë pjestarë të komunitetit ndërkombëtar dhe që veprojnë si subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Si operacion juridik (*negotium iuris*), traktati është përkufizuar përgjithësisht si mirëkuptim midis dy ose më shumë shtetesh, me anë të së cilit përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke si dhe vendosen norma sjelljeje që shtetet detyrohen t'i respektojnë.² Por, traktati mund të përkufizohet edhe si një instrument (*instrumentum iuris*) ku materializohet pajtimi i vullnetit të shteteve.³ Po kështu, për autorë të tjerë, traktati ndërkombëtar presupozon çdolloj angazhimi konsensual në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe që përbën një nga mekanizmat, me anën e të cilave, subjektet e së drejtës Traktatet ndërkombëtare në pikëtakimin e të drejtës ndërkombëtare publike me degë të tjera të së drejtës

ndërkombëtare fitojnë të drejta dhe marrin përsipër detyrime⁴. Oppenheim i përkufizonte traktatet ndërkombëtare si marrëveshje me karakter konsensual që realizohen midis shteteve ose organizatave ndërkombëtare dhe që krijojnë të drejta dhe detyrime midis tyre⁵, ndërsa Shwarzenberger e përkufizonte traktatin si një angazhim konsensual që subjektet e së drejtës ndërkombëtare marrin në raport me njëri-tjetrin, me qëllim për të krijuar detyrime juridike, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Në të drejtën ndërkombëtare, me traktat kuptohet çdolloj akordi, marrëveshje ose konventë, në kuptimin më të gjerë, që përfundohet midis anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar⁶. Traktati ose akordi ndërkombëtar konsiston në përputhjen e deklaratave të vullnetit, të cilat dy ose me shumë subjekte të së drejtës ndërkombëtare i bëjnë, me synimin për të vendosur midis tyre të drejta dhe detyrime, sipas një sjelljeje të caktuar që secila palë merr përsipër ta respektojë⁷.

Traktati përfaqëson pajtimin e vullnetit të dy ose më shumë shteteve apo subjekteve të tjera të së drejtës ndërkombëtare, me anë të të cilit vendosen raporte midis tyre që udhëhiqen nga e drejta ndërkombëtare, ose, sikurse thuhet në ditët e sotme, traktati nënkupton një marrëveshje të shkruar, me anë të së cilës dy ose më shumë shtete apo organizata ndërkombëtare krijojnë ose përpiqen të krijojnë midis tyre një raport që vepron në sferën e të drejtës ndërkombëtare⁸, ose sikurse shprehen disa autorë të së drejtës ndërkombëtare, “traktatet janë marrëveshje të vullnetshme që lidhen midis shteteve, përfshi edhe organizatat shtetërore, me qëllim për të krijuar të drejta dhe detyrime midis palëve”⁹. Për autorë të tjerë, “traktatet janë si kontratat në legjislacionin e një vendi..., por që lidhen ndërmjet qeverive të dy a më shumë shteteve sovrane”¹⁰.

Traktati ndërkombëtar është i destinuar të prodhojë efekte të së drejtës. Ky efekt juridik konsiston në vendosjen e një rregulli, pra të një norme sjelljeje që aplikohet, në mënyrë permanente, për një numur të pakufizuar situatash (është rasti, të cilit i referohet neni 38 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë). Por efekti juridik mund të konsistojë dhe në detyrimin për të dhënë, për të bërë apo për të mos bërë: si p.sh., një traktat për të kryer një pagesë ose për të akorduar një të drejtë apo avantazh, për të njohur një obligim si të tejkaluar etj. Në këtë mënyrë, procedura e traktatit mund të përfshijë situata të krahasueshme me atë që në të drejtën kombëtare quhet kontratë, nga njëra anë, dhe ligje apo rregulla, nga ana tjetër. Në doktrinë, bëhet dallimi ndërmjet traktateve-ligje, në të cilat palët

kanë vullnet të njëjtë, duan të njëjtën gjë dhe vendosin rregulla të përbashkëta për të gjithë, si dhe traktatet-kontratë, me anë të të cilave palët ndjekin gjëra të ndryshme dhe parashikojnë përfitime reciproke.

II. Pikëtakimi i të drejtës civile me të drejtën ndërkombëtare private

Lidhja e pazgjidhshme e të drejtës civile me të drejtën ndërkombëtare private është jashtë çdo dyshimi. Kështu, sipas opinionit të disa autorëve, e drejta ndërkombëtare private nuk mund të jetë degë e veçantë e së drejtës, por thjesht pjesë e të drejtës civile. Kjo për arësyen e thjeshtë se si e drejta civile, ashtu edhe ajo ndërkombëtare private, kanë si objekt raportin juridik civil. Ndryshimi qëndron në faktin se e drejta ndërkombëtare private, ndryshe nga e drejta civile, ndjek raportin juridik civil jo në kontekstin e brendshëm, por në atë ndërkombëtar.

Një ndër veçoritë kryesore të raportit juridik të së drejtës ndërkombëtare private është elementi e *ekstraneitetit ose elementi i huaj*, i cili përbën faktorin kryesor që na ndihmon të dallojmë raportet juridike të së drejtës ndërkombëtare private nga raportet e tjera juridike. Nëse do ta përkufizonim, me element të huaj kuptojmë atë pjesë përbërëse të raportit juridik që ndodhet në territorin e një shteti të huaj, ose nën autoritetin e një ligji të huaj. Elementi është i huaj, në raport me ligjin shqiptar, ose shtetin shqiptar, në rastin tonë. Në fakt, elementi i huaj nuk përbën një element strukture të dallueshëm të raportit juridik, krahas subjekteve, përmbajtjes dhe objektit, por secila prej tyre mund të shfaqet si element i huaj. Do të paraqesim më poshtë elementët kryesorë të huaj që mund të shfaqen në lidhje me tri elementët e strukturës së vetë raportit juridik:

A. Elementët e huaj në lidhje me subjektet e raportit juridik dallohen në funksion të llojit të tyre. Kështu, për *personat fizikë* mund të jenë elementë të huaj: shtetësia, vendbanimi ose rezidenca dhe, në disa sisteme të së drejtës, edhe feja ose besimi fetar. Për *personat juridikë*, elementët kryesorë të huaj janë: shtetësia, selia, fondi tregtar apo fondet financiare etj. Këto janë kryesisht elementë të ekstraneitetit që janë të huaja ose ndodhen në një vend të huaj.

B. Në lidhje me objektin (e prejardhur) e raportit juridik, pra pasuria e luajtshme ose e paluajtshme, elementi i huaj ekziston atëhere kur kjo pasuri Traktatet ndërkombëtare në pikëtakimin e të drejtës ndërkombëtare publike me degë të tjera të së drejtës

ndodhet jashtë vendit, ose, edhe në rast se ndodhet brenda vendit, është subjekt i një ligji të huaj (p.sh., pasuria e një ambasade të huaj në Rumani ose në Shqipëri).

C. Sa i përket përmbajtjes së raportit juridik, duke qënë se ai krijohet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve, është jo material dhe materializohet nëpërmjet elementëve faktikë, të cilët, kur ndodhen në një shtet të huaj, ose varen prej ligjit të huaj, përbëjnë elementë të huaj.

Konflikti i ligjeve është një tjetër veçori që lind si pasojë e prezencës së elementit të huaj në një raport juridik. Nëse do të tentonim një përkufizim juridik, me konflikt ligjesh kuptojmë situatën që shfaqet në rastin kur, në një raport juridik, ekziston një element i huaj, pra kur ai raporti juridik është i aftë që të pranojë aplikimin e dy ose më shumë sistemeve të së drejtës, të cilat u përkasin shteteve të ndryshme. Nga përkufizimi juridik i nocionit të konfliktit të ligjeve burojnë elemente thelbësore të këtij institucioni, sikurse vijon:

- a) burim i konfliktit të ligjeve është në fakt vetë elementi i huaj. Vetëm prezenca e një elementi të huaj në një raporti juridik bën të mundur lindjen e konfliktit të ligjeve, duke e kthyer, në mënyrë të tërthortë, atë raport juridik në një raport të së drejtës ndërkombëtare private.
- b) konflikti i ligjeve nuk implikon, në asnjë rast, ndonjë konflikt sovranitetesh, midis shtetit shqiptar ose rumun dhe shtetit të huaj, me të cilin ka lidhje elementi i huaj. Kjo pasi gjyqtari rumun, ose shqiptar respekton vetëm ligjin e vendit të tij. Në këtë kuptim, konflikti i ligjeve do të zgjidhet nga norma e konfliktit, e cila për gjyqtarin shqiptar, është gjithmonë ajo shqiptare (e brendshme ose e përfshirë në një konventë ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë), ashtu sikurse për gjyqtarin rumun do të ketë përparësi norma e Rumanisë.
- c) raporti juridik që përmban një element të huaj është i aftë që të pranojë aplikimin e dy ose më shumë sistemeve juridike të ndryshme. Në fakt, raporti juridik është në gjendje t'i nënshtrohet dy ose më shumë sistemeve juridike të ndryshme, pasi, përmes mekanizmit të normës së konfliktit, atij i aplikohet vetëm një sistem i së drejtës, pra pikërisht ai që tregon vetë norma e konfliktit, si *lex causae*. Ky sistem mund të jetë

nga legjislacioni rumun, nga legjislacioni shqiptar, ose nga ai i shtetit të huaj.

- d) konflikti i ligjeve shfaqet midis sistemeve të së drejtës të shteteve të ndryshme. Kështu, në sintagmën “konflikt ligjesh”, nocioni i ligjit duhet nënkuptuar si konflikt sistemesh të së drejtës që u përkasin shteteve të ndryshme. Në një raport juridik, mund të shfaqet një ose disa konflikte ligjesh, ashtu sikurse mund të ketë një ose më shumë elementë të huaj.

Përmes këtyre karakteristikave, raporti juridik i të drejtës ndërkombëtare private dallon nga raporti juridik i së drejtës ndërkombëtare publike, pasi raporti juridik me element të huaj vendoset midis personave fizikë ose juridikë. Në cilësinë e tij edhe si subjekt i të drejtës civile, shteti mund të jetë palë në një raport juridik me element të huaj. Ky pozicion i shtetit nuk duhet ngatërruar me atë ku shteti merr pjesë në një raport juridik të së drejtës ndërkombëtare publike. Kështu, ndodh që disa shtete lidhin ndonjëherë kontrata bashkëpunimi ekonomik dhe tekniko-shkencor me firma të vendeve të tjera, në emrin e tyre si subjekte të së drejtës civile, duke përfutur kështu cilësinë e palës kontraktuese. Pjesëmarrja e shteteve drejtpërsëdrejti në raporte juridike të së drejtës ndërkombëtare private, shtron problemin se deri në çfarë mase mund të përdoret rruga e arbitrazhit për të zgjidhur mosmarrëveshjet që mund të rezultojnë nga raporte të tilla, rrugë, e cila dallon nga çdo lloj tjetër mënyre paqësore për zgjidhjen e konflikteve që lindin midis shteteve.

III. Roli i traktatit ndërkombëtar në rastin e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare

Në parim, e drejta e tregtisë ndërkombëtare përbëhet nga tërësia e normave që rregullojnë raportet pasurore, me karakter tregtar dhe ndërkombëtar, lidhur midis personave fizikë dhe/ose juridikë shqiptarë ose rumunë dhe të huaj (që përmbushin cilësinë e subjektit të së drejtës për operacionet e import-eksportit), përfshi raportet midis këtyre personave dhe shtetit – nëse shteti vepron si *de jure gestionis* – raporte këto ku palët ndodhen në pozitat e barazisë juridike. Në përmbajtjen e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare hyjnë gjithashtu edhe norma të tjera juridike, të cilat, për nga natyra e tyre, u përkasin degëve ose disiplinave të tjera juridike, por që inkadrohen tek e drejta e tregtisë ndërkombëtare për shkak të objektit të tyre

rregullues specifik, pra të raporteve të caktuara juridike që shfaqen në kuadrin e tregtisë ndërkombëtare të një shteti¹¹.

Mungesa e karakterit specifik të normave juridike bën që e drejta e tregtisë ndërkombëtare të mos jetë në vetvete një degë e sistemit të së drejtës kombëtare. *E drejta e tregtisë ndërkombëtare është më tepër një lëndë juridike shumëdisiplinare*, në përmbajtjen e së cilës, hyjnë norma juridike, të cilat u takojnë degëve të ndryshme të së drejtës. Vetëm se, nga ana tjetër, duhet theksuar fakti se këto norma ofrojnë zgjidhje specifike që i shmangen të drejtës tregtare dhe asaj civile, karakteristikë kjo që i jep të drejtës së tregtisë ndërkombëtare një farë autonomie kundrejt degëve të tjera të së drejtës. Por, cili është raporti i të drejtës së tregtisë ndërkombëtare me degë të tjera të së drejtës ?

A. Lidhja reciproke me të drejtën tregtare (të brendshme).

Raportet juridike të së drejtës së tregtisë ndërkombëtare ngjajnë thelbësisht me ato të së drejtës tregtare të brendshme, për faktin se të dyja këto kategori raportesh juridike kanë karakter pasuror dhe tregtar. Aspekti tregtar, si karakteristikë e përbashkët, vjen nga fakti se që të dyja burojnë prej akteve e fakteve të tregtisë, ndërsa subjektet e tyre janë persona fizikë dhe juridikë që paraqesin cilësinë prej tregtari. Ashtu sikurse është vënë re në literaturën e specialitetit¹², uniteti thelbësor i këtyre dy raporteve juridikë rrjedh prej faktit se ato qeverisen nga të njëjtat akte normative të brendshme. Në këtë mënyrë, shumë prej akteve normative që dispijlojnë raportet tregtare të brendshme dhe të tregtisë ndërkombëtare, ia nënshtrojnë pa dallim këto raporte të njëjtave ligje, kryesisht Kodit tregtar dhe Kodit civil. Kështu, e drejta e tregtisë ndërkombëtare, si lëndë shumëdisiplinare, merr një pjesë nga normat që i përkasin, në thelb, të drejtës tregtare, duke u shfaqur si një e drejtë e veçantë kundrejt asaj tregtare, e cila mbetet e drejtë e përbashkët në fushën e raporteve tregtare. Nga ana tjetër, raportet tregtare ndërkombëtare dallojnë nga ato të brendshme, kryesisht prej faktit se, në përbërje të tyre, shfaqen elementë të huaj specifikë, të cilët i bëjnë ato të afta t'u përshtaten dy ose më shumë sistemeve të ndryshme të së drejtës. Për pasojë, lidhur me raportet e tregtisë ndërkombëtare, shfaqet një konflikt ligjor, i cili ndikon që ato t'i nënshtrohen të drejtës së brendshme, vetëm nëse ajo është një *lex causae*, në bazë të normës konfliktuale të zbatueshme në këtë rast. Por, në shumicën e rasteve, raportet juridike, të cilave iu referohemi, qeverisen nga konventa ndërkombëtare ose rregullime ligjore uniforme, të cilat shfaqen si burime të tregtisë ndërkombëtare, veçse jo edhe si burime të së drejtës së

brendshme tregtare. Në fushën e tregtisë ndërkombëtare aplikohen, gjithashtu si burime specifike, edhe praktikat e tregtisë ndërkombëtare.

B. Lidhja me të drejtën civile dhe të drejtën e procedurës civile. E drejta e tregtisë ndërkombëtare paraqit elementë të rëndësishëm të përbashkët me të drejtën civile dhe atë të procedurës civile. Sikurse kemi theksuar deri tani, e drejta e tregtisë ndërkombëtare është lëndë juridike shumëdisiplinare, pasi normat e saj janë jo vetëm norma të brendshme tregtare, por edhe norma të së drejtës civile dhe të drejtës së procedurës civile. Ky identitet në thelbin e përmbajtjes, manifestohet nëpërmjet metodës së disiplinimit ligjor të përbashkët, e cila konsiston në barazinë juridike të palëve, si në të drejtën civile dhe të procedurës civile, ashtu edhe në të drejtën e tregtisë ndërkombëtare, duke bërë pjesë kështu në fushën e të drejtës private. E drejta civile dhe e drejta e procedurës civile përbëjnë të drejtën e përgjithshme kundrejt të drejtës së tregtisë ndërkombëtare, ndaj dispozitat e tyre aplikohen sa herë rregullimet ligjore të veçanta në fushën e tregtisë ndërkombëtare nuk janë të mjaftueshme, ose kur nuk ekzistojnë fare rregullime ligjore specifike në nivelin e të drejtës së brendshme tregtare, e cila përbën, sikurse e kemi theksuar, një të drejtë të përbashkët për raportet tregtare.

Vlen të evidentohet fakti se, të paktën sa i përket të drejtës së procedurës civile, vetëm normat e të drejtës së procedurës civile në përgjithësi e kanë karakterin e një të drejte të brendshme për të drejtën e tregtisë ndërkombëtare, ndërsa procedurat që i referohen fushave të veçanta nuk e kanë këtë karakteristikë. Kjo ide është shprehur fare qartë në dispozitat e rregullave procedurale që aplikohen në rastin e arbitrazhit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tregtisë ndërkombëtare, si edhe në një sërë nenesh të rregullave procedurale që zbatohen në arbitrazhin tregtar *ad hoc* të Gjykatës së arbitrazhit tregtar ndërkombëtar, pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, e cila ka saktësuar se këto rregulla plotësohen me dispozitat e të drejtës së brendshme, në masën që ato janë të aplikueshme, nëse kemi parasysh karakterin ndërkombëtar të kompetencës së Gjykatës së arbitrazhit dhe natyrën kryesisht tregtare të mosmarrëveshjeve¹³. Nga ana e tyre, disa rregullime ligjore që aplikohen me përparësi në fushën e tregtisë së brendshme dhe ndërkombëtare luajnë rolin, përmes kodit tregtar, e të drejtës së përgjithshme për disa raporte të së drejtës civile. Ndërmjet të

drejtës së tregtisë ndërkombëtare dhe të drejtës civile¹⁴ ekzistojnë dallime të rëndësishme, të paktën për arësyet e mëposhtme:

- a) ndërsa subjektet e të drejtës civile, qofshin persona fizikë ose juridikë, nuk paraqesin cilësi të veçanta, subjektet e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare janë persona fizikë ose juridikë me zotësi të veçantë për të kryer operacione të tregtisë së jashtme;
- b) raportet e të drejtës civile janë pasurore dhe jo pasurore personale, në kohën që raportet e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare janë, në parim, pasurore;
- c) raportet juridike që janë objekt i të drejtës ndërkombëtare përmbushin karakteristikat specifike të tregtisë dhe ndërkombëtarizmit.

C. Lidhja me të drejtën ndërkombëtare private. Ashtu si raportet juridike që përbëjnë objektin e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare, edhe raportet e të drejtës ndërkombëtare private paraqesin karakter ndërkombëtarizmi, ndonëse në ndonjë rast, sfera e nocionit të ndërkombëtarizmit është më e kufizuar për kategorinë e parë të raporteve juridike. Të dyja fushat juridike bëjnë pjesë në të drejtën private, pasi raportet juridike që përbëjnë objektin e tyre kryesor, karakterizohen nga barazia juridike e palëve. Dallimi kryesor midis të drejtës së tregtisë ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare private qëndron tek natyra e normave juridike që hyjnë në përmbajtjen e tyre. Kështu, ndërsa normat e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare janë materiale, normat që hyjnë në përmbajtjen e të drejtës ndërkombëtare private janë, në shumicën e tyre, norma konfliktuale. Edhe objekti i tyre, në këndvështrimin e të drejtës ndërkombëtare private, është gjithashtu i ndryshëm. Me të vërtetë, nëse e drejta e tregtisë ndërkombëtare ka për objekt raportet juridike që shfaqen në fushën e tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar, e drejta ndërkombëtare private rregullon raportet juridike me element të huaj në të gjitha fushat e të drejtës private.

D. Lidhja me të drejtën ndërkombëtare publike. Dallimi kryesor midis të drejtës së tregtisë ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare publike konsiston në natyrën dhe pozitën juridike të subjekteve. E drejta e tregtisë ndërkombëtare rregullon, në parim, raportet midis personave fizikë ose juridikë që ndodhen në një pozicion barazie juridike. Gjithashtu, në

objektin e të drejtës së tregtisë ndërkombëtare bëjnë pjesë edhe raportet juridike tregtare, ku njera nga palët është vetë shteti, ndërsa pala tjetër është person fizik ose juridik i një shteti tjetër. Edhe në këtë rast, kushti thelbësor për ekzistencën e raporteve të së drejtës së tregtisë ndërkombëtare, është që palët të jenë në pozita të barazisë juridike, pra shteti të veprojë si subjekt i të drejtës civile (*de jure gestionis*.) Raportet juridike midis shteteve që veprojnë si fuqi sovrane (*de jure imperii*), midis shteteve dhe organizatave qeveritare ndërkombëtare dhe midis vetë këtyre organizatave bëjnë pjesë në sferën e rregullimeve ligjore të së drejtës ndërkombëtare publike, dhe ekzaktësisht të së drejtës ndërkombëtare ekonomike dhe të drejtës ndërkombëtare të zhvillimit, si degë e të drejtës ndërkombëtare publike, atëhere kur këto raporte juridike kanë të bëjnë me fushën e bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar¹⁵. Ndërmjet të drejtës së tregtisë ndërkombëtare dhe të drejtës ndërkombëtare publike ekzistojnë megjithatë pika të rëndësishme konvergjente, të cilat burojnë pikësëpari, nga elementi i të qenit ndërkombëtar që karakterizon raportet juridike, raporte këto që përbëjnë edhe objektin e dy të drejtave të sipërpërmendura. Kështu, parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare publike aplikohen edhe në kuadrin e raporteve të së drejtës së tregtisë ndërkombëtare dhe, *a fortiori*, në ato ku merr pjesë edhe shteti. Korrelacioni, ose lidhja reciproke midis këtyre dy lëndëve juridike shfaqet më dukshëm në disa rrethana të caktuara, si p.sh, sa i përket pasojave që marrëveshjet ekonomike ndërshtetërore prodhojnë mbi kontratat e tregtisë ndërkombëtare.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Jules Basdevant, La conclusion et la redaction des traites, in R.C.A.D.I, vol 15, 1926, f.539-643; A.D.Mc.Nair, The Law of Treaties, Oxford 1961; Schwarzenberger, A Manual of International Law, vëll 1, 1967 (ref. Traktate, f.151); A.Maresca, Il diritto dei Trattati, Milano, 1971; T.O.Elias, The modern Law of Treaties, Oceana, 1974; M.Molea, Dreptul tratatelor internationale, Editura Academiei, 1988; Hoijer, Les traites internationaux, Paris 1926; I.M.Sinclair, The Vienna Convention on the Law of Treaties, Manchester University Press, 1973; I.Detter, Law Making by International Organizations, Stockholm, 1965

2. Dictionnaire de la terminologie du droit international, Paris, 1960, f.607; R.Genet, Traite de diplomatie et du droit diplomatique, vol3, Paris 1032, f.353.

3. Dallimi midis “marreveshjes juridike” dhe instrumentit ku ajo shfaqet, manifestohet, vec te tjersh, edhe ne faktin se, ndonëse marrëveshja juridike përbën një akt unik, duhen më shumë instrumente për ta konstatuar atë (J.Basdevant, “La conclusion et la redaction des instruments diplomatiques autre que les traits”, R.C.A.D.I, 1926, vëll. 15, f.554).

4. Schwarzenberger, International Law, vëll.1, International Courts 3d edit.London, 1957, f.421

5. L. Oppenheim, “International Law. A Treatise”, vëll. I, Peace, ed. By H.Lauterpacht, f.877.

6. Ch.Rousseau, “Droit International public”, vol 1, Paris, 1970, f.6

7. Zejnullah Gruda, “E drejta ndërkombëtare publike”, Botim i Furkan ISM-Shkup, Viti 2007, f.287

8. Mc.Nair, f. 3-4

9. Lauterpacht, Raporti i pare, paraqitur në Komisionin e të drejtës ndërkombëtare mbi problemin e kodifikimit të së drejtës së traktateve.

10. Martin Dixon “E drejta ndërkombëtare”, Bot. Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, f.68

11. Për përpufizime të tjera të së drejtës së tregtisë ndërkombëtare në literaturën rumune të specialitetit, shih Paul.I.Demetrescu “Interprinderile comerciale”, Bucuresti, Edit.Cercetari juridice, 1943, f.7; Al.Detesan, I.Rucureanu, B.Stefanescu “Dreptul comertului international”, në R.E.I, vëll. I, 1976, f.15; I.Dogaru, T.R.Popescu, C.Mocanu, M.Rusu, “Principii si institutii in dreptul comertului international”, Edit.Scrisul Romanesc, 1980, f.22-23; I.Macovei “Dreptul comertului international”, Edit.Junimea, 1980, f.9; I.Rucareanu, B.Stefanescu, M.Pascu, E.Gluvacob, N.Turcu-Seclaman “Dreptul comertului international”, A.S.E, 1981, f.6; B.Stefanescu, I.Rucareanu “Dreptul comertului international”, Edit.Didactica si

Pedagogica, 1983, f.5 dhe 8-9; O.Capatina, B.Stefanescu “Tratat de drept al comertului international”, vëll.I, Pjesa e përgjithshme, Edit.Academiei, 1985, f.22-23; I.Bacanu “Dreptu comertului international” in Dictionar Juridic de Comert Exterior, f.162; I.Macovei “Institutii in dreptul comertului international” Edit.Junimea, 1987, f.11-13; M.N.Constantin, Sergiu Deleanu “Dreptul commercial international”, Vëll.I, Pjesa e përgjithshme, Edi.LuminaLex, 1994, f.5.

12. V.Patulea, C.Turianu “Elemente de drept commercial”, Edit. Sansa, 1993, f.17; S.Carpenaru, vep.cit., f.10-11

13. Të dyja rregullat, të cilave u referohemi janë aprovuar nga Kolegji i Gjykatës së Arbitrazhit, me anë të vendimit nr.1, 17.11.1993 dhe kanë hyrë në fuqi në 1.01.1994. Për aplikimin e të drejtës së procedurës civile si e drejtë e përgjithshme për raportet juridike të tregtisë ndërkombëtare, shih dispozitat e nenit 51 të ish Rregullores C.A.B.; 1976, identike në përmbajtje me ato të nenit 52 dhe 73 të dokumentave të fuqi; O.Capatina,, J.r.d.i.p. (XXVI), në R.R.S.I., nr. 2/1979, f.262-263; I.Racureanu, S.Zilberstein “Dreptul material si dreptul procesual civil aplicabile ca *lex causae* raporturilor comerciale internationale in Romania”, në I.D.C.I., vëll.2, f.198-200.

14. Lidhur me përkufizimin e të drejtës civile, shih Gheorghe Beleiu “Dreptul civil roman, Introducose in dreptul civil. Subiectele dreptului civil”, Casa de Editura si Presa Sansa S.R.L. Bucuresti, 1993, f.25 e në vazhdim.

15. Shih për këtë rast Gr.Geamanu “Drept international public”, vëll.II, E.D.P., 1883, f.312-383; A.Bolintineanu, B.Stefanescu “Cateva consideratii asupra trasaturilor specifice ale dreptului international economic si delimitarii sale in dreptul dezvoltarii, in R.R.S.I., nr.2/1984, f. 91-97.

Edelajda Cenaj – Çepa

Doktorante QSA, Tiranë

Kodikët e Shqipërisë - Impresione vizive - Estetika dhe etika e përsosur e tyre

Përmbledhje

Të shohësh, të prekësh, të studiosh kodikët¹ do të thotë të njohësh realitetin e një kohe të largët, të kuptosh mbi identitetet e atyre që krijuan, shkruan apo ruajtën këto vlera të jashtëzakonshme e të pazëvendësueshme.

Studimi i kodikëve përbën një interesim të pashmangshëm të shkencave etno-kulturore si dhe objekt studimi i antropologjisë kulturore. Kodikët nuk sjellin të dhëna vetëm rreth besimit të krishterë, formave dhe zhvillimit të tij, por më së shumti rreth krijimit, shkrimit dhe ruajtjes së tyre në trevat iliro-shqiptare që prej paleokrishtimit e deri sot.

Koleksioni i kodikëve ruhet në Arkivin Qëndror të Shtetit në Shqipëri dhe përbëhet nga njëqind vëllime, që përbëjnë vepra të plota (dorëshkrime) dhe shtatëmbëdhjetë fragmente.

Kodiku më i hershëm daton në shek. VI e. s. (i mirënjohuri Kodiku i Purpurt i Beratit²) dhe më i voni është i gjysmës së parë të shek XVII e. s.

¹ Kodikët janë libra në dorëshkrim, që përmbajnë Shkrime të Shenjta biblike, ungjillore, a gjeografike. Kodikët konsiderohen si dëshmitë më të hershme të historisë të shkrimit nëpër trevat shqiptare. (shih Shaban Sinani, “Kodikët e Shqipërisë në kujtesën e Botës”, ASH, Tiranë, 2010)

Në këtë punim vëmendja është përqëndruar kryesisht në ndërtimin dhe pamjen e jashtme të kodikëve (shkrimi, dekorimi, materiali) të ruajtur në AQSH.³

1. Shkrimi i përdorur tek kodikët

Që me një vëzhgim të shkujdesur bërë kodikëve të ndryshëm, të periudhave të ndryshme, dallohen lehtësisht llojet dhe stili i veçantë i shkrimit të përdorur në to. Vihet re një spektër i gjërë shkronjash, numrash e simbolesh të tjerë të përdorur ku në mënyrë të njëtrajtshme e ku të ndërthurur midis tyre. Në disa kodikë vërehet harmonizim i llojeve të ndryshëm të shkrimeve, ndonjëherë në dukje pa shumë lidhje mes tyre, por në thelb në përputhje me logjikën e kodikut përkatës.

² Skëndi, S.: *"The political evolution in Albania"*, Qendra për studimet e Europës Qendrore e Komitetit Kombëtar për Europën e lirë, New York, Seri e mimeografuar, 8 mars 1954, f. 160.

³ USDS 875.00/266: Tirana, nr. 542, 22 tetor 1928.

një komision i posaçëm që do të përcakonte direktivat kryesore të këtij projekti të madh.

Në thelbin e saj, reforma parashikonte shpronësimin e pjesshëm të pronarëve të mëdhenj, duke u marrë prej tyre vetëm ajo pjesë e pronës që konsiderohej e tepërt dhe njëkohësisht ajo tentoi të pjestonte pasurinë e këtij vendi, duke shtuar numrin e pronarëve të vegjël e bujqve⁴. Pjesa e tepërt, e përmendur më sipër, nxirrej nëpërmjet disa llogaritjesh. Kështu një çifligari i llogaritej se për nevojat familjare i duheshin 40 hektarë tokë (kur familja përbëhej me më pak se pesë veta; për çdo pjestar tjetër shtoheshin pesë hektarë më shumë). Sasia e tokës që mbetej mbi këtë shumë ndahej në tre pjesë: dy prej tyre i mbeteshin pronarit, të cilat ai i shfrytëzonte nëpërmjet punës së çifçinjve, ndërsa një e treta do t'i takonte bujkut dhe në këtë mënyrë do të konsiderohej pronar. Gjithashtu, vetë reforma parashikonte se jo çdokush do të mund të bëhej me tokë (rreth dy të tretat e bujqve pa tokë ose me pak tokë do të përfitonin prej saj); ajo duhet të paguhej dhe të mirëmbahej.

Nga ana tjetër, familja e bujkut përfitonte prej reformës agrare 0.5 hektarë tokë për frymë, por në çfarëdolloj rasti kjo sasi nuk do t'i kalonte 5 hektarë. Kurse, për të gjitha ato familje bujqish, të cilat zotëronin një farë toke, por që nuk i kalonte 5 hektarët, Zyra Agrare do të kryente kompensimin për pjesën e mbetur. Të gjithë personat që parashikoheshin si përfitues prej Reformës Agrare, duhet të paraqisnin një kërkesë pranë Zyrës Agrare, duke përcaktuar edhe vendin e tokës që ata do të dëshironin të kishin. Kjo e fundit lidhej me Zyrën e Hipotekave dhe i transmetonte listën e përfituesve, bashkë me sipërfaqet përkatëse të tokave. Kujtojmë se, me hyrjen në fuqi të Kodit Civil të 1929, u suprimuan kadastrat dhe me anë të ligjit të 17.04.1929 *“Mbi zyrat e hipotekave dhe taksat e tyre”*, u krijuan këto zyra hipotekore. Si hap i fundit, bëhej transkriptimi i akteve të pronësisë në regjistrat kadastralë, që njihnin zyrtarisht kalimin e pronësisë dhe njohjen e saj⁵, por gjithashtu bëhej

⁴ Selenica, T.: *“Shqipëria në 1937”*, vëll. II, Tiranë, 1938, f. 885.

⁵ Historiku dhe funksioni i ZRPP-së, në <http://www.zrpp.gov.al/mat.php?idr=310&idm=12&lang=1>, konsultuar më 06.11.2013, f.1.

edhe inskriptimi i hipotekave të reja dhe të drejtave të tjera reale të tokës në mjedise urbane dhe bujqësore.

II.

Konceptet bazë për mbrojtjen e statusit të pronarit dhe tagrave që lidhen me këtë të fundit u konsakruan si nga Kushtetuta në nenin 198, e cila shprehej se *“E drejta e pronësisë, për çfarëdolloj pasunije që të jetë, është e padhunueshme; pa mos qenë e vërtetuese rregullisht nevoja e interesit botnuer, dhe pa mos u pague vlefte e arsyeshme, si mbas ligjës së posaçme, nuk mund të shpronësohet pasunija e kurkujt”*, por gjithashtu edhe nga Kodi Civil, i cili bënte një rregullim më të detajuar të pronës. Megjithë ndryshimet legjislative, nuk ishte siguruar ende drejtësia sociale dhe për këtë duhet të shërbente parimisht dhe praktikisht reforma agrare. Dyshimet e mosfunksionimit të kësaj reforme lidhen drejtpërdrejtë me përpiluesit e kësaj të fundit: pronarët e mëdhenj. Duke qenë se një prej pikave të kësaj reforme ishte shpronësimi deri në një masë të caktuar të këtyre pronarëve, mund të themi se në pozitat që ata ishin në legjislativ, e bënë situatën kompromentuese.

Megjithatë, shpronësimi do të sillte disa aspekte të rëndësishme, si për mbrojtjen e shtresave të varfra të shoqërisë, si në rritjen dhe zhvillimin e bujqësisë si degë thelbësore e ekonomisë shqiptare, por gjithashtu edhe heqjen e pjesshme të së drejtës së pronësisë nga disa persona vetëm me të drejtën e kundërshtpërblimit, si element i rëndësishëm demokratik. Nga ky arsyetim kuptojmë se reforma agrare e përjashtonte konfiskimin, ashtu sikurse edhe Kushtetuta në nenin 208⁶, i cili shpjegon se *“Konfiskimi asht i ndaluem dhe s’mund të bëhet veçse mbas ligjës me vendim gjyqi”*.

Gjithashtu krijimi i Bankës Kombëtare të Bujqësisë dhe i kontratës-tip ishin dy elementë inovatorë dhe përparimtarë që mendohej se do të sillnin zhvillim sipas reformës agrare. E para do të shërbente si institucion i rëndësishëm kreditimi, sidomos për fshatarët që kërkonin të investonin

⁶ AQSH, Fletore Zyrtare nr.111, datë 13 Dhjetor 1928, *“Statuti i Mbretërisë Shqiptare”*.

kryesisht në mjete të reja pune, duke suprimuar kamatën që deri në këtë periudhë, i bënte fshatarët të hiqnin totalisht dorë nga toka dhe nga frytet e saj. Duhet thënë se kamata mund të shkonte nga 50-100% të vlerës së huasë së marrë dhe jepej kryesisht nga myltezimët, nga tregtarët e mesëm të qyteteve, të cilët e shihnin këtë formë huadhënie si një mënyrë fitimi, pavarësisht pasojave sociale që ajo sillte⁷.

Banka Kombëtare Bujqësore u krijua si institucion kreditimi, i nevojshëm për mbështetjen e Reformës Agrare me ligjin e 3 maj 1930, por ajo nuk filloi të funksiononte deri në vitin 1937. Ajo kishte për qëllim dhënien e kredive për kryerjen e veprimtarive agrare, përmirësimin e pronës, kultivimin, administrimin dhe transformimin e saj. Kjo bankë do të fillonte të funksiononte pasi të ishte kryer derdhja e 1/3 së kapitalit të paravendosur prej 5.000.000 frangash ari⁸. Ky kapital fillestar do të krijohej prej çmimit të tokave të shpronësuara në favor të bujqve proletarë, të mbeturat nga huaja e ish Bankës së sundimit osman që kishin hyrë në të ardhurat e shtetit dhe të hyrat e tjera që do të vinin pas zbatimit të Reformës Agrare⁹. Pavarësisht qëllimit madhor që kishte kjo bankë, përsëri ajo nuk i kreu funksionet për të cilat ajo ishte krijuar.

Ndërsa përsa i përket kontratës-tip, ajo kishte si qëllim të përmbyste regjimin e mëparshëm pronar-bujk dhe të vendoste marrëdhënie kontraktuale mes palëve, duke shfaqur vullnetin e të dyja palëve dhe pëlqimin për kushtet e vëna. Ajo do të përcaktonte të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke u bazuar në Kodin Civil, por edhe në zakonet e mira që kishte çdo zonë e Shqipërisë. Ajo kishte për qëllim, de jure, të vendoste në të njëjtin plan dhe t'ju jepte të njëjtën rëndësi palëve, si pronarëve të mëdhenj, ashtu edhe fshatarëve me pak tokë, ose pa tokë fare. Pra, ajo i siguronte bujqve, të cilët nuk kishin tokë

⁷ Lorenzoni, G.: *“Çështja agrare shqiptare”*, Shtypshkronja *“Mbrothësia”*, K. P. Luarasi, Tiranë, 1930, f. 123.

⁸ Neni 1: *“Formohet një Bankë bujqësore kombtare me kapital fillestar fillimtar prej 5.000.000 (pesë milion) fr. ari. Banka fillon nga veprimet e veta po sa të derdhet një e dheta e këtij kapitali”*.

⁹ AQSH, Fletore Zyrtare, nr. 60, dt. 08. 09. 1931, *“Ligji për Reformën Agrare”*.

të mjaftueshme, të punonin në toka private, duke vendosur vijat e përgjithshme të “marrëdhënies koloniale” midis sipërmarrësve dhe punëtorëve bujqësorë¹⁰.

III.

Shpronësimi do të bënte të mundur krijimin e pronarëve të rinj, të cilët do të gëzonin një pronë të caktuar, pa patur ndërmjetësinë e shtetit apo të personave të tretë. Kategoritë e personave që do të përfitonin nga reforma përfshinin: çdo bujk të martuar ose të ve, çdo e ve bujku me fëmijët e saj, fëmijët e bujqve të mbetur jetimë, bujqit proletarë me pasuri të vogël dhe të pamjaftueshme, mbi moshën 60 vjeçare, personat e pazotë për të vepruar për shkak të të metave të tyre fizike dhe mendore dhe çdo person tjetër që nuk siguronte dot minimumin jetik¹¹.

Megjithatë, ligji kishte parashikuar një kufizim që lidhej me mënyrën e shfrytëzimit të pronës. Ai shprehej se shteti mund ta rimernte pronën e “dhuruar”, në rast se toka nuk do të punohej rregullisht. Pronari i ri duhet të deklaronte se do të tentonte gjithnjë të përmirësonte tokën dhe ta kryente një akt të tillë. Ai kishte si detyrim ligjor përmirësimin e saj, ndërkohë që një pronar i vërtetë, në raport me sendin mund të sillte ashtu siç ka dëshirë. Madje ai edhe mund ta shkatërrojë atë tërësisht, sigurisht pa dëmtuar apo cënuar të drejtat e të tretëve. Në këtë rast duket se reforma agrare nuk e njeh të drejtën për të disponuar lirisht sendin, duke qenë se pronarit i vihen kufizime në mënyrat e përdorimit të saj dhe sanksioni në rast të moszbatimit të këtyre të fundit, çonte sërish në shpronësim.

Për ta zbutur pak këtë dispozitë, gjithsesi parashikohej se “Brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit agrar, pronarët janë të detyruar të parashitrojnë përpara zyrës agrare gjendjen mbi ndryshimin bujqësor sipas kapacitetit të tokës, duke ndarë tokat e tyre në zona dhe duke treguar se cilat janë zonat prioritare, çfarë punësh do të bëhen në to, cilat do të jenë mjetet

¹⁰ Selenica, T.: “Shqipëria në 1937”, vëll. II, Tiranë, 1938, f. 884.

¹¹ AQSH, f. 894, v. 1939, d. 600, “Pasqyrë mbi statistikën bujqësore të Reformës Agrare”, f. 17.

financiare që do përdorën, këto ndryshime do të bëhen vetë apo me qiramarrës” (neni 32). Sipas këtij neni kuptojmë se ligji kishte lënë disa margjina kohorë për t’i përgatitur pronarët e rinj. Pavarësisht kësaj, kjo nuk e justifikon cënimin e drejtpërdrejtë të tagrave të pronësisë.

Shpronësimi, siç edhe është përmendur më parë kryhej me kundërshtëpërblim dhe masa fillestar e kësaj shume shkonte nga 100-160 franga ari. Në fakt, me këtë shumë u abuzua prej pronarëve të mëdhenj, duke arritur shifra të papërballueshme, për të cilat asnjë fshatar nuk ishte në gjendje të paguante (600-700)¹². Duke parë këtë formë abuzimi, u vendos se kundërshtëpërblimi do të merrte trajtën e një pagese prej 20 frangash ari, si formë simbolike e kalimit të pronësisë. Si kufizim tjetër, që do të ishte në mbrojtje të pronarëve të mëdhenj, u vendos gjithashtu se në asnjë lloj rasti nuk mund të shpronësohej një person, në rast se ai do të zotëronte deri në 100 hektarë tokë. Nga ana tjetër, përjashtoheshin nga shpronësimi kullotat, pyjet, vreshtat, ullishtat, kopshtet dhe pemishtet, vendet arkeologjike, guroret si dhe çdo tokë tjetër me destinacion publik që mund të shfrytëzohej nga shteti.

Gjithashtu shpronësimi, ashtu sikurse ishte renditur edhe në Kodin Civil të 1929, do të konsiderohej si një prej formave të fitimit të pronësisë për palën përfituese. Prandaj, konstatimi i mësipërm bie deri diku në kundërshtim me çka po themi në vazhdim, duke qenë se fitim pronësie me kusht nuk ka në shkencën juridike. Pronat shtetërore do të ishin pasuritë e para që do të viheheshin në shërbim të personave pa tokë, ose me pak tokë, sipas reformës agrare. Duhet thënë se pronarët e mëdhenj gëzonin më shumë prona së bashku, se sa vetë shteti, gjë që e bën ironik vendin e privilegjuar të tyre. Proporcioni midis pronave private dhe atyre shtetërore mendohej të ishte 2/3 me 1/3, pronësi që shtrihej në të gjitha zonat fushore të Shqipërisë, e përqëndruar në afërsisht 165 familje¹³.

¹² Kareco, T.: *“Reforma agrare demokratike nga një Monark”*, në *“Monarkia shqiptare 1929-1938”*, Qendra e studimeve albanologjike, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 90.

¹³ Selenica, T.: *“Shqipëria në 1937”*, vëll. II, , Tiranë, 1938, f. 883.

Ligji për reformën agrare preku 8109,5 hektarë tokë, ku 3411,5 hektarë i përkisnin pronave shtetërore dhe 4698 hektarë ishin prona private¹⁴. Sasia e kësaj toke nuk i plotësonte pritshmëritë e shtetit shqiptar për zbatimin e kësaj reforme. Siç duket prej këtyre të dhënave, u vu në dispozicion edhe prona shtetërore në një sasi të konsiderueshme, të krahasueshme me pronën private që iu mor personave fizikë.

IV.

Ashtu sikurse edhe në çdo aspekt tjetër social, ekonomik, politik etj, edhe në aspektin pronësor, shteti shqiptar ka mbajtur një qëndrim më të butë e tolerant ndaj minoriteteve dhe zotërimeve të tyre. Ndërkohë që, në vende të tjerë ballkanikë si Serbia, apo Greqia minoritetet po largoheshin me dhunë, duke cënuar kështu të gjithë katalogun e të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e pronës, në Shqipëri u mbajt një qëndrim krejtësisht ndryshe.

Përgjatë Monarkisë, shteti shqiptar nuk ndoqi asnjë lloj politike shpronësuese ndaj pakicave etnike të asaj kohe, që jetonin në Shqipëri. Për ta theksuar akoma më tepër këtë ide, vlen të përmendet fakti se minoritetet që jetonin në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930 e përmirësuan gjendjen e tyre ekonomike dhe krijuan një status më të përparuar në shoqëri.

Përpara se të krijoheshin shteti shqiptar, pjesa më e madhe e kësaj popullsie minoritare kishin statusin e bujkut çifçi, por ky status erdhi gjithnjë e duke u përmirësuar¹⁵, sidomos me hyrjen në fuqi të ligjeve mbi qeramarrjen e tokave bujqësore. Kjo solli kalimin e kategorisë nga bujku pa tokë, në bujk me tokë, duke hedhur një hap të rëndësishëm për këtë kategori personash dhe duke iu atribuar titullin pronar.

¹⁴ Historia e Shqipërisë, vëll. II, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, Tiranë, 1965, f. 601.

¹⁵ Meta, B.: *“Politikat e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë periudhës së monarkisë”*, në *“Monarkia shqiptare 1929-1938”*, Qendra e studimeve albanologjike, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 47.

Pra, pozita e pakicave kombëtare erdhi duke u konsoliduar, jo vetëm sociologjikisht, por edhe ekonomikisht, duke qenë se dhënia e pronave përforcoi gjendjen e tyre financiare dhe rriti sigurinë e jetesës në një vend si Shqipëria. I vetmi rast, ku shteti nuk arriti të shuante konfliktin e pronarit të fshatit Goricë, Maliq bej Frashëri me bujqit që punonin në këtë fshat, solli si rezultat largimin përfundimtar të banorëve nga Shqipëria. Edhe me familje të tjera nga Kosova dhe vende të tjerë në Ballkan, u ndoqën politika strehuese, të rëndësishme për kohën, që prekën rreth 20,000 të shpërngulur, të cilët u sistemuan kryesisht në Fier dhe Durrës falë reformës agrare¹⁶.

Që në kohën kur u mblodh Konferenca e parë ballkanike, u bë qartësisht i njohur qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj minoriteteve, duke qenë se edhe vetë si shtet kishte një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së tij që jetonin jashtë shtetit, sidomos në vende si Jugosllavia dhe Greqia. Prandaj, delegacioni i drejtuar prej Mehmet Konicës propozonte krijimin e një projekti që do të mbronte pakicat kombëtare dhe në të njëjtën kohë, mbrojtjen reciproke të shteteve ballkanike në rast sulmesh nga Fuqitë e Mëdha¹⁷. Ky propozim u mbështet kryesisht nga Bullgaria, e cila ndodhej në të njëjtën situatë si Shqipëria, por u mor gjithashtu edhe një aprovim i heshtur nga Turqia dhe Rumania, ndërkohë që delegacioni serb pati rezervat e veta mbi këtë çështje¹⁸. Pra, kjo dëshmon, ashtu sikurse u përmend edhe mësipër se çështja e minoriteteve ishte e rëndësishme për shtetin shqiptar, sepse duke mbrojtur pakicat e huaja, shpresohet të mbroheshin edhe pakicat tona në vendet ballkanike, duke përfshirë këtu mbrojtjen e të gjithë të drejtave të njeriut dhe në mënyrë më specifike, të të drejtave pronësore.

Përfundime

¹⁶ Verli, M.: *“Interesimi i shtetit shqiptar për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20-30 të shek. XX”*, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 223.

¹⁷ Shahini, A.: *“Albania Between Italy and the First Balkan Conference 1930”*, Mediterranean Journal of Social Sciences, vol. 3, shtator 2012, f.2.

¹⁸ AQSH, P.151, D.103, V.1930, P.154.

Megjithë pritshmëritë e hartuesve të ligjit agrar, reforma u zbatua në një masë të parëndësishme dhe pas vitit 1935 ajo u harrua tërësisht nga pushteti qendror. Në dispozicion të kësaj reforme u vendos një sasi e konsiderueshme toke, por duhet thënë se një pjesë e madhe prej saj ishte e papunueshme prej dekadash dhe kërkonte investime të mëdha për ta risjellë atë në jetë, gjë që bujku nuk mund ta realizonte.

Kështu që në një farë mënyre u rivendosën pozitat si mëparë, ku çifligari shfrytëzonte çifçiun dhe ku vetë shteti përdorte forcën për të detyruar të parin të paguante të dhjetën dhe taksat shtetërore. Gjithashtu, duhet theksuar se reforma ishte praktikisht e pa aplikueshme, duke qenë se *“Për një hektar të shpronësuar dhe të shpërndarë për instalimin e fshatarëve pa tokë, me pak tokë dhe të emigrantëve u harxhuan 117 fr. ari. Kujtojmë se vetë fshatari paguante vetëm 20 fr. ari për tokën e përfutur”*¹⁹.

Për më tepër, disa studiues e shohin reformën agrare, jo vetëm të dështuar dhe të pa aplikuar në vend, por gjithashtu edhe si mjet ndëshkues që mund ta përdorte mbreti kundra ndonjë pronari të madh tokash, që nuk ka ndjekur rregullat e këtij të fundit, ose më thjeshtë nuk i është bindur²⁰. Gjithashtu, si pjesë e reformës agrare ishin edhe ngritja e Bankës

Bujqësore dhe kontratës-tip, por e para hyri në funksion me shumë vonesë dhe nuk influencoi aspak në mbështetjen e pronarëve të rinj, kurse e dyta u zbeh shpejt, për arsye se elementët kontraktues nuk ishin bërë ende praktikë e zakonshme për shqiptarët. Këta të fundit e kishin më të kollajtë t’i riktheheshin marrëdhënieve feudale, se sa t’i përshtateshin legjislacionit të ri.

Bibliografi

1. Historia e Shqipërisë, vëll. II, Instituti i historisë dhe i gjuhësisë, Tiranë, 1965.

¹⁹ Kareco, T.: *“Reforma agrare demokratike nga një Monark”*, në *“Monarkia shqiptare 1929-1938”*, Qendra e studimeve albanologjike, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 95.

²⁰ Villari, G. dhe Truddaiu M.: *“L’Albania alle soglie del XX secolo”*, Notiziario del Centro Numismatico Valdostano, Anno II, N. 3, qershor 2006, f. 7.

2. Kareco, T.: *“Reforma agrare demokratike nga një Monark”*, në *“Monarkia shqiptare 1929-1938”*, Qendra e studimeve albanologjike, Botimet Toena, Tiranë, 2011.
3. Meta, B.: *“Politikat e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë periudhës së monarkisë”*, në *“Monarkia shqiptare 1929-1938”*, Qendra e studimeve albanologjike, Botimet Toena, Tiranë, 2011.
4. Selenica, T.: *“Shqipëria në 1937”*, vëll. II, Tiranë, 1938.
5. Lorenzoni, G.: *“Çështja agrare shqiptare”*, Shtypshkronja *“Mbrothësia”*, K. P. Luarasi, Tiranë, 1930.
6. Skëndi, S.: *“The political evolution in Albania”*, Qendra për studimet e Europës Qendrore e Komitetit Kombëtar për Europën e lirë, New York, 8 mars 1954.
7. Shahini, A.: *“Albania Between Italy and the First Balkan Conference 1930”*, Mediterranean Journal of Social Sciences, vol. 3, shtator 2012.
8. Verli, M.: *“Interesimi i shtetit shqiptare për shqiptarët në Jugosllavi në vitet 20-30 të shek. XX”*, Botimet Toena, Tiranë, 2011.
9. Villari, G. dhe Truddaiu M.: *“L’Albania alle soglie del XX secolo”*, Notiziario del Centro Numismatico Valdostano, Anno II, N. 3, qershor 2006.

Burime arkivore

1. AQSH, P.151, D.103, V.1930, P.154.
2. AQSH, f. 894, v. 1939, d. 600, *“Pasqyrë mbi statistikën bujqësore të Reformës Agrare”*.
3. AQSH, Fletore Zyrtare nr.111, datë 13 Dhjetor 1928, *“Statuti i Mbretërisë Shqiptare”*.
4. AQSH, Fletore Zyrtare, nr. 60, dt. 08. 09. 1931, *“Ligji për Reformën Agrare”*.
5. USDS 875.00/266: Tirana, nr. 542, 22 tetor 1928.

La naissance et la chute de la réforme agraire en Albanie

Après la seconde guerre mondiale, les pays européens ont élaboré et appliqué des réformes politiques et sociales, qui avaient pour but d'éliminer les injustices sociales. De même, ces derniers ont mis en oeuvre une réforme sur les terres, appelée "La réforme agraire". Dans l'Albanie de cette époque, les relations entre les propriétaires et les paysans étaient médiévales, et c'est pour cette raison que depuis la constitution de la République Albanaise dirigée par Ahmet Zogu, des démarches ont été prises.

L'idée initiale était de redistribuer les terres de cultures en les confisquant à leurs propriétaires sans les payer. Mais Ahmet Zogu avait peur de la leurs réaction, et il ne voulait pas les avoir contre lui, surtout les grands propriétaires. Ainsi, la réforme prévoyait que les grands propriétaires conservaient la plupart de la leur propriété, et ils ne devaient donner que la partie considérée comme "de trop". De cette façon, une famille de paysans pouvait peu profiter de cette réforme, car à chaque personne s'attribuait 0,5 hectare de terre, et n'aucun cas ça ne pouvait pas dépasser les 5 hectares.

En plus, le paiement de l'expropriation était prévue d'une somme de 100-160 francs en or par hectare. Cette somme était difficile d'être payée par les paysans, et elle est devenue au prix fort parce que les propriétaires ont profité de la situation terrible où ces gens vivaient, et ils ont augmenté le prix à 600-700 francs en or par hectare. Enfin, l'État Albanais a consacré une loi selon laquelle le prix a été fixé à 20 francs en or par hectare. Il faut aussi préciser que toutes les personnes qui achetaient ces terres, avaient ainsi l'obligation de les cultiver, de les bien maintenir, sinon l'État intervenait en les réconfisquant.

Même si la loi sur la réforme agraire a été considérée comme l'une des lois les plus démocratiques de cette époque, elle n'a pas répondu aux nécessités des citoyens. En effet, elle a touché 4698 hectares de terres des personnes privées, et 3411,5 hectares de terres qui appartenaient à l'État. Au total, il y avait 8109,5 hectares de terres utilisés pour contenter les gens. Ça veut dire que cette loi n'a pas été réussie dans un point de vue sociologique, car elle n'a pas aidé à ressoudre la situation des paysans dans le pays; mais elle a quand même construit une base démocratique, et juridique.

LIRIDON ZENKU

***UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I
STRUGËS***

**Adresa: Mehmed Mehmedi Nr. 31 Kërçovë R.
Maqedonisë**

e-mail: zenku78@hotmail.com

**ZHVILLIMI, NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI
I LIGJIT PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE
PRIVATE NGA PERIUDHA 1982 DERI MË VITIN
2013**

1. Përmbledhje

E drejta ndërkombëtare private është privilegj i çdo personi në Republikën e Maqedonisë (R.M) dhe në rrozullin tokësor. Prandaj duhet pasur kujdes gjatë propozimit dhe aprovimit të ligjeve për të drejtat e njeriut,

e në vençanti për të drejtat ndërkombëtare private ku mbrohen të drejtat private të personit fizik.

Zhvillimi, ndryshimi dhe plotësimi i këtij ligji nëpër etapa, gjegjësisht në periudhën e viteve 1982 deri më vitin 2013 në R. Maqedonisë ose thënë ndryshe krahasimi i ligjit për zgjidhjen e ndeshjeve të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në mardhënie të caktuara, dhe ligji për të drejta ndërkombëtare private, në periudhën e para dhe pas demokracisë, do të shihet në vazhdim, ku do të jepet edhe argumentim për përparsitë dhe mangësitë e këtyre ndryshimeve të bëra, si nga këndvështrimi juridik ashtu dhe shkencor si dhe do të theksohen edhe ndryshimet e tjera që janë bërë dhe duhen bërë në nene dhe paragrafe të këtij ligji për avancimin dhe përmisimi e të drejtës ndërkombëtare private në R. Maqedonisë dhe në tërë botën.

Po ashtu është bërë një analizë e ndryshimeve të këtij ligji, dhe jamë i bindur që nga analizat më të shpeshta mund të zbulohen edhe gabimet ose përmisimet dhe shkaqet e tyre, kështu që do të lehtësohet puna e detektimit të atyre faktorëve që sjellin mos përmbushjen e obligimeve dhe eliminimi i tyre, në rastin konkret ndryshimi dhe plotësimi, modifikimi dhe përsosja e atyre neneve ose paragrafëve që sjellin mos përmbushjen e obligimeve për të drejtën ndërkombëtare private. Në fund të këtij punimi trajtohen edhe sfidat drejtë të së ardhmes në shoqërin Ballkanike, Evropjane, dhe Botërore.

2.Fjalët çelës: Ligji, zhvillimi, ndryshimi , plotsimi, miratimi.

1 . Summary (Abstract)

Private international law is the prerogative of every person in the Republic of Macedonia (RM) and the globe too. Therefore, we must be taking care during the nomination and approval of laws for human rights, particularly private international rights where private rights are protected.

Development, changes, and amendments of the law in stages, ie in the period from 1982 to 2013 in the Republic of Macedonia or in other words the comparison of law for resolution matches with the provisions of the laws of other countries in certain relations, and international private law, in the period before and after democracy. We will be seen in the sequel, which will also be provided for grounding the advantages and disadvantages of these

changes that are made, as well as from a legal perspective and research. They will outline other changes that have been made and should be made in the articles and paragraphs of this law for the advancement and improvement of international private law in the Republic of Macedonia and throughout the world.

It is also an analysis of the changes to this law, and I am convinced that the more frequent tests may be disclosed or upgrades errors and their causes, so that the work will facilitate detection of those factors that doesn't meet the obligations and their elimination. At the end of this paper we dealt with the challenges of the future rights in Balkan society, European , and World .

Key words : law , development , amendment, supplement approval

Hyrje

Ashtu si që u theksua edhe në pjesën e përmbledhjes në këtë punim është ndjekur zhvillimi dhe ndryshimi i ligjit për të drejtat ndërkombëtare private nga periudha e para demokracisë dhe pas demokracisë në mes të ligjeve të vitit 1982, 2007, 2013 dhe janë treguar përparsitë dhe mangësit e këtyre ndryshimeve duke argumentuar arsyen.

Jamë i bindur që duke analizuar më shpeshëherë këtë ligj mund të reflektohen edhe mangësit dhe shkaqet e tyre, kështu që lehtësohet puna e detektimit të atyre faktorve që sjellin suksese apo mos suksese dhe aplikimi apo eliminimi i tyre, në rastin konkret ndryshimi i atyre neneve ose paragrafve që sjellin mos zgjidhjen apo zgjidhjen e konflikteve të personit fizik.

Zhvillimi ndryshimi dhe plotsimi në Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private

Në ishë Jugosllavinë më vitin 1982 u soll ligj për zgjidhjen e ndeshjeve të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në mardhënie të caktuara. Ky ligjë përbën rregulla për të drejtat statutare, familjare matrijale, respektivisht

Zhvillimi, ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për të drejtën ndërkombëtare private nga periudha 1982 deri më vitin 2013

mardhënjet e tjera matrijale – juridike me elemente ndërkombëtare. Po ashtu ky ligj përmban dhe rregulla për kompetencat e gjyqeve dhe organeve të tjera të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (R.S.F.J).

Nëse ndonji person i R.S.F.J ka dhe shtetësi të ndonji shteti të tjetër, atëherë për përdorimin e këtij ligji vihet në përdorim vetëm shtetësia e R.S.F.J. Nëqoftse personi ka më shumë shtetësi atëherë shtetësia verifikohet sipas vendëbanimit ose e verifikon gjyqi ose ndonjë organ tjetër që është kompetent për atë punë dhe në mënyrë zyrtare do ta verifikoi përmbajtjen e ligjit që aplikohet – zbatohet në shtetin e huaj.

Ligji-aplikueshëm-zbatueshëm

Për aftësin ligjore dhe të biznesit të personit fizik përdoret ligji i aplikueshëm – zbatueshëm i atij shteti i cili person është shtetas i atij shteti.

Për vendosje nën kujdestari (i mbrojturi) dhe përfundimi i kujdestaris si dhe mardhëniet midis kujdestarit dhe personit nën kujdestari (i mbrojturi) është i vlefshëm ligji i zbatueshëm i atij shteti i cili person është shtetasi.

Mbrotje e përkohshme ndaj shtetasit e huaj dhe ndaj personave pa shtetësi të cilët gjenden në R.S.F.J përcaktohet me ligj të R.S.F.J dhe zgjat përderisa shteti kompetent nuk sjell vendim dhe nuk merrë masa të nevojshme, kjo vlen edhe për mbrojtjen e pronës nëse personi i huaj mungon dhe për personat pa shtetësi.

Shpallja e një personi të zhdukur ose të vdekur është i vlefshëm ligji i atij shteti i cili person ka qenë shtetas në kohën kur është zhdukur ose ka vdekur.

Për pronësi dhe mardhëniet juridike dhe të drejtat e tjera vlen ligji i atij vendi (shteti) ku gjendet sendi apo lënda si punë juridike.

Për mjetet transportuese vlen ligji i atij shteti të cilët mjete i takojnë.

Për kontrata vlen ligji të cilin e kanë zgjedhur palët në fjalë nëse me ligjin ndërkombëtar nuk është përcaktuar ndryshe.

Për trashigues vlen ligji i atij shteti i cili person ka qenë shtetas gjatë kohës kur ka vdekur.

Aftësi për të bër një dëshmi (testament) është i vlefshëm ligji i atij shteti të cilën shtetësi e ka pasë personi në momentin kur e ka bër dëshmin (testamentin). Dëshmi (testamenti) është i plotëfuqishëm në aspektin e formës, nëse është i plotëfuqishëm në bazë të një prej të drejtave të mëposhtme :

- Sipas ligjit të vendit ku është bërë dëshmia (testamenti);
- 1) Sipas ligjit të shtetit i cili shtetas ka qenë në kohën e vlefshmëris së dëshmisë në kohën kur ka ndërue jetë personi;
- 2) Sipas ligjit të vendëbanimit në kohën e dispozicionit me dëshmin (testamentin) gjatë kohës së vdekjes;
- 3) Sipas ligjit (të drejtës) për qëndrim në kohën e dispozicionit me dëshmin në momentin kur ka vdekur;
- 4) Sipas të drejtës (ligjit) të R.S.F.J;
- 5) Për pasuri të patundshme – sipas së drejtës në të cilin vend gjendet pasuria e patundshme.
- 6) Revokim i dëshmisë (testamentit) është i plotëfuqishëm në aspektin e formës, nëse ajo formë është e plotëfuqishme.
- 7) Në funksion të kushteve për martesë vlen e drejta e atij shteti edhe ate për secilin person i cili është shtetas i atij shteti ku bën martesën edhe për shkurorzim vlen i njeiti ligj. Edhe për të gjitha procedurat e tjera dhe për çdo person vlen ligji i atij shteti ku është krye veprimi apo kontrata.

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të shteteve të huaja, vendim gjyqësor i shteteve të huaja bazohet me vendimet e gjyqit të R.S.F.J dhe prodhon veprim juridik në R.S.F.J nëse e pranon gjyqi i R.S.F.J. Vendim gjyqësor i shteteve të huaja do të pranohet nëse ekziston barazim gjyqësor, e kurse vendim gjyqësor i huaj nuk do të pranohet nëse është në kundërshtim me kushtetutën e R.S.F.J. Për pranimin dhe realizimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe arbitrazhe është përgjegjës gjyqi vendor në të cilin vend duhet të veprohet për pranimin respektivisht realizimi i atij vendimi.

Vendime të veçanta-Shtetasit e R.S.F.J mund të përpilojnë testament ose ndonjë nevojë tjetër juridike në konzullata ose në njësit diplomatike të R.S.F.J. Njësit diplomatike dhe konzullatat të R.S.F.J në shtetet e huaja mund të vërtetojnë nënshkrime, dorshkrime dhe përshkrime në përputhshmëri me kontratat ndërkombëtare dhe me rregullat e atij shteti që e pranon.

LIGJI PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE (2007)

Ky ligj përban rregulla për përcaktimin e së drejtës kompetente për marrdhëniet personale (statusore), familjare, të punës, pronsore dhe marrdhëniet e tjera matriale – juridike me element ndërkombëtar.

Ky ligj poashtu përban edhe rregulla për kompetencën e gjykatave dhe organeve të tjera të Republikës së Maqedonisë, për shqyrtimin e marrëdhënieve nga ky ligj, rregulla të procedurës dhe rregulla për pranimin e vendimeve të huaja gjygjësore dhe vendimeve të organeve të tjera të shtetit të huaj.

Dispozita e këtij ligji nuk zbatohet për marrëdhëniet nga ky ligji, nëse janë të rregulluara me ligj tjetër, ose me marrëveshje ndërkombëtare.

Klauzola për vetëpërrjashtim, e drejta për të cilën udhëzojnë dispozitat e këtij ligji, me përjashtim, nuk do të zbatohet nëse duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, duket qartë se marrdhënia me atë të drejtë nuk ka lidhje më të rëndësishme, ndërsa ekziston lidhje më e ngushtë esenciale me ndonji të drejtë tjetër.

Plotësimi i zbrazëtirave juridike, Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për të drejtën kompetente për ndonjë marrdhënie, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat dhe parimet e këtij ligji, parimet e rregullimit juridik të Republikës së Maqedonisë dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare private.

Rendi publik, e drejta e shtetit të huaj nuk zbatohet, nëse pasojat nga zbatimi i saj do të jenë në kundërshtim me rendin publik të R. Maqedonisë.

Kundërpërgjegjia dhe udhëzimi

1.Nëse sipas dispozitave të këtij ligji, do të duhej të zbatohet e drejta e shtetit të huaj merren parasysh rregullat e tij për përcaktimin e së drejtës kompetente.

2.Nëse rregullat e shtetit të huaj për përcaktimin e së drejtës kompetente i kundërpërgjigjen të drejtës së R. Maqedonisë, do të zbatohet e drejta e R. Maqedonisë, duke mos i marrë parasysh rregullat për përcaktimin e së drejtës kompetente.

Forma e çështjes juridike dhe veprimi juridik , nëse me këtë ligj dhe me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe, konsiderohet se çështja juridike dhe veprimi juridik në aspektin e formës janë të plotfuqishme, nëse janë të plotfuqishme qoftë sipas së drejtës në vendin ku është lidhur çështja juridike përkatësisht është ndërmarrë veprim juridik.

Zbatimi i të drejtës së huaj, e drejta e shtetit të huaj, zbatohet sipas kuptimit të vet dhe të nocioneve që i përmban.

Rendi juridik jo-unik

1.Nëse është kompetente e drejta e shtetit, rendi juridik i të cilit nuk është unik, ndërsa rregullat e këtij ligji nuk udhëzojnë për rajonin e caktuar juridik në atë shtet, e drejta kompetente përcaktohet sipas rregullave të atij rendi juridik.

2.Nëse në mënyrën e paraparë me këtë ligj, nuk është e mundur që të përcaktohet cila e drejtë është kompetente në shtetin rendi juridik i të cilit nuk është unik, kompetente është e drejta e rajonit në atë shtet me të cilin ekziston lidhje më e ngushtë.

Personat me më shumë shtetësi, nëse personi që është shtetas i R. Maqedonisë e ka edhe shtetësinë e ndonjë shteti tjetër, për zbatimin e këtij ligji konsiderohet se ka vetëm shtetësinë e R. Maqedonisë.

1.Nëse personi që nuk është shtetas i R. Maqedonisë ka dy ose më tepër shtetësi të huaja, për zbatimin e këtij ligji konsiderohet se e ka shtetësinë e atij shteti, shtetas i të cilit është dhe ku e ka vendbanimin.

2.Nëse personi nuk ka vendbanim në asnjë shtet, shtetas i të cilave është për zbatimin e këtij ligji konsiderohet se e ka shtetësinë e atij shteti, shtetas i të cilit është dhe me të cilin ka lidhje më të ngushtë.

Personat pa shtetësi

1.Nëse personi nuk ka shtetësi ose shtetësia e tij nuk mund të konfirmohet, e drejta kompetente përcaktohet sipas vendbanimit të tij.

2.Nëse personi nuk ka vendbanim ose ai nuk mund të konfirmohet, e drejta kompetente përcaktohet sipas vendqëndrimit të tij.

3.Nëse nuk mund të konfirmohet as vendqëndrimi i personit, atëhere kompetente është e drejta e R. Maqedonisë.

Përcaktimi i të drejtës së huaj

a)Gjykata ose organi tjetër i përcaktuar me ligj, me detyrë zyrtare do ta përcaktojë përmbajtjen e së drejtës kompetente të huaj.

b)Palët në procedurë mund të paraqesin edhe dokumentin publik për përmbajtjen e të drejtës së huaj.

c)Nëse me rastin e caktuar përmbajtja e të drejtës së huaj nuk mund të konfirmohet në njërin nga mënyrat e lartëpërmendura, atëhere zbatohet e drejta e R. Maqedonisë.

Aftësia juridike dhe aftësia për punë e personit fizik

Për aftësi juridike dhe aftësi për punë të personit fizik, kompetente është e drejta e shtetit, shtetas i të cilit është ai person.

Aftësia juridike dhe aftësia për punë e personit juridik, kompetente është e drejta e shtetit të cilit ai i përket.

Personi juridik e ka përkatësin e atij shteti, sipas të drejtës së të cilit është themeluar.

Nëse personi juridik vërtet ka seli në shtetin tjetër e jo në atë ku është themeluar, dhe sipas të drejtës së atij shteti tjetër e ka përkatësin e tij, do të konsiderohet si person juridik i atij shteti.

- Shpallja e personit të zhdukur si i vdekur, kompetente është e drejta e shtetit, shtetas i të cilit ka qenë ai person në kohën e zhdukjes.

- Për emrin e personit fizik kompetente është e drejta e shtetit, shtetas i cili është ai person.

Pronësia dhe të drejtat e tjera reale mbi sendet, për marrëdhënjet pronësore juridike dhe për të drejtat e tjera reale mbi sendet, kompetente është e drejta e vendit ku gjendet sendi.

Për marrëveshje – rregulla e përgjithshme, kompetente është e drejta që e kanë zgjedhur palët në marrëveshje, nëse me këtë ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare, nuk është përcaktuar ndryshe. Plotëfuqishmëria e marrëveshjes për zgjedhjen e së drejtës kompetente, vlersohet sipas të drejtës së zgjedhur.

Për marrëveshjet që kanë të bëjnë me patundshmëritë, ekskluzivisht është kompetente e drejta e shtetit, në territorin e të cilit gjendet patundshmëria.

Për marrëveshje për punësim, nëse palët nuk e kanë zgjedhur të drejtën kompetente, kompetente është e drejta e shtetit në të cilin sipas marrëveshjes puntori zakonisht e kryen punën përkohësisht në shtet tjetër.

Për çështjen juridike plotësuese, nëse me çështjen juridike ose me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, do të zbatohet e drejta që është kompetente për çështjen kryesore juridike.

Për çështjen e njëanshme juridike, kompetente është e drejta e shtetit të vendbanimit të debitorit i cili është person juridik.

Për trashigimi, kompetente është e drejta e shtetit, shtetas i të cilit ka qenë trashëgimlënësi në kohën e vdekjes.

Zhvillimi, ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për të drejtën ndërkombëtare private nga periudha 1982 deri më vitin 2013

Për aftësin e përpilimit të testamentit, kompetente është e drejta e shtetit, shtetësinë e të cilit e ka pasur testamentlënësi, në momentin e përpilimit të testamentit.

Forma e testamentit

Testamenti është i plotfuqishëm në aspektin e formës, nëse është i plotfuqishëm sipas njërës nga të drejtat si vijonë :

1. E drejta e vendit ku është përpiluar testament;
2. E drejta e shtetit, shtetas i të cilit ka qenë testamentlënësi, qoftë në kohën kur ka disponuar me testamentin, qoftë në kohën e vdekjes;
3. E drejta e vendbanimit të testamentlënësit, qoftë në kohën kur ka disponuar me testamentin, qoftë në kohën e vdekjes;
4. E drejta e vendqëndrimit të testamentlënësit, qoftë në kohën kur ka disponuar me testamentin, qoftë në kohën e vdekjes;
5. E drejta në Republikën e Maqedonisë.

Revokimi i testamentit është i plotfuqishëm në aspektin e formës, nëse ajo formë është e plotfuqishme sipas cilësdo të drejte me të cilën, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, testamenti ka mundur të përpilohet në mënyrë të plotfuqishme.

Kushtet për lidhjen e martesës, në aspektin e kushteve për lidhjen e martesës, për secilin person, kompetente është e drejta e shtetit, shtetas i të cilit është ai person në kohën e martesës. Për formën e martesës, kompetente është e drejta e vendit ku lidhet martesa.

Për prishjen e martesës, kompetente është e drejta e shtetit, shtetas të të cilit janë të dy bashkëshortët, në kohën e paraqitjes së padisë.

Rregulla e përgjithshme për kompetencën ndërkombëtare, kompetenca e gjykatës të Republikës së Maqedonisë ekziston, nëse i padituri ka vendbanim përkatësisht seli në Republikën e Maqedonisë.

Nëse i padituri nuk ka vendbanim në R. Maqedonisë, as në ndonjë shtet tjetër, kompetenca e gjyqit të R. Maqedonisë ekziston, nëse i padituri e ka vendqëndrimin në R. Maqedonisë.

Gjygji i R. Maqedonisë është kompetent edhe për kundërpadi, nëse kërkesa nga kundërpadia është në lidhje me kërkesën e padisë.

Kompetenca në procedurën jashtëkontestimore, kur për marrëdhënien juridike vendoset në procedurën jashtëkontestimore, kompetenca e gjyqit të Republikës së Maqedonisë ekziston, nëse personi ndaj të cilit është paraqitur kërkesa e ka vendbanimin përkatësisht selin në R. Maqedonisë, ndërsa kur në procedurë merr pjesë vetëm një person, nëse ai person e ka vendbanimin përkatësisht selin në R. Maqedonisë, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Kompetenca ekskluzive ndërkombëtare – rregulla e përgjithshme, Gjygji i R. Maqedonisë është ekskluzivisht kompetent, kur kjo është e përcaktuar në mënyrë të prerë me këtë ligj .

Marrëveshja për kompetencën ndërkombëtare, palët mund të merren vesh për kompetencën e gjykatës së huaj, vetëm nëse së paku njëra nga ato është shtetas i huaj ose person juridik me seli jashtë vendit, ndërsa nuk bëhet fjalë për kotestin për të cilin sipas dispozitave të këtij ligji apo ligjit tjetër, ekziston kompetencë ekskluzive e gjyqit të R. Maqedonisë. Palët mund të merren vesh për kompetencën e gjyqit të R. Maqedonisë, nëse së paku njëra palë është shtetas i R. Maqedonisë, ose person juridik me seli në R. Maqedonisë.

Kompetenca e veçantë ndërkombëtare për personat pa shtetësi, kur me dispozitat e këtij ligji, kompetenca e gjyqit të R. Maqedonisë është përcaktuar me supozimin se pala e gjykimit e ka shtetësinë e R. Maqedonisë, ajo kompetencë ekziston edhe për personat pa shtetësi që kanë vendbanim në R. Maqedonisë.

Kompetenca ndërkombëtare për kontestet kundër shtetasve të R. Maqedonisë, që janë me punë jashtë vendit, në kontestet kundër shtetasve të R. Maqedonisë që jetojnë jashtë vendit, ku për të shërbyer ose

për të punuar i ka dërguar organi shtetëror, kompetenca e gjyqit të R. Maqedonisë ekziston, nëse ata në momentin e dërgimit të atill e kanë pasur vendbanimin në R. Maqedonisë.

Kompetenca ekskluzive ndërkombëtare, për kontestet lidhur me patundshmëritë, Gjyqi i R. Maqedonisë është ekskluzivisht kompetent, për kontestet e pronësisë dhe të drejtave të tjera reale të patundshmërive, në kontestet për shkak të pengimit të zotritimit me patundshmërinë, si dhe për kontestet e ndodhura nga marrëdhëniet e qiradhënjes ose qiramarrjes së patundshmërive, ose nga marrveshjet për shfrytëzimin e banesës ose lokaleve afariste, nëse patundshmëria gjendet në territorin e R. Maqedonisë.

Kompetenca ndërkombëtare për kontestet, për shkak të pengimit të zotritimit të sendeve të tundshme, në kontestet për shkak të pengimit të zotritimit të sendeve të tundshme, kompetenca e gjyqit të R. Maqedonisë gjithashtu ekziston, edhe nëse në territorin e R. Maqedonisë ka ndodhur pengimi.

Kompetenca ndërkombëtare për shqyrtimin e trashëgimisë së shtetasit të huaj, edhe për kontestet nga marrëdhëniet juridike trashëgimore, edhe për kërkesën e kreditorve ndaj trashëgimisë së shtetasit të huaj. Për shqyrtimin e trashëgimisë së patundshme të shtetasit të huaj, ekskluzivisht është kompetent gjyqi i R. Maqedonisë, nëse patundshmëritë gjenden në R. Maqedonisë.

Për shqyrtimin e trashëgimisë së tundshme të shtetasit të huaj që gjendet në R e Maqedonisë, kompetent është gjyqi i R. Maqedonisë, përveç nëse në shtetin e trashëgimlënësit gjyqi nuk është kompetent, për shqyrtimin e pronës së tundshme të shtetasit të R. Maqedonisë.

1. Dispozitat nga ky ligj, kanë të bëjnë edhe me kompetencën në kontestet nga marrëdhëniet trashëgimore juridike dhe në kontestet për kërkesat e kreditorve ndaj trashëgimisë.

2. Kur nuk ekziston kompetenca e gjyqit të R. Maqedonisë për shqyrtimin e trashëgimisë së shtetasit të huaj, gjyqi mund të përcaktojë masa për sigurimin e trashëgimisë, dhe për mbrojtjen e të drejtave ndaj trashëgimisë që gjendet në R. Maqedonisë.

Kompetenca ndërkombëtare për ndërmarrjen e masave të përkohshme ndaj shtetasit të huaj, Organi i R. Maqedonisë do të ndërmarrë masa të domosdoshme të përkohshme, për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të shtetasit të huaj, i cili gjendet ose ka pronë në R. Maqedonisë, për këtë do ta njoftojë organin e shtetit, shtetas i të cilit është ai person.

Organi i R. Maqedonisë do të marrë vendim dhe do të ndërmarrë masa në punët e tutorisë së shtetasit të huaj, i cili ka vendbanim në R. Maqedonisë, nëse mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të tij, nuk e ka siguruar organi i shtetit, shtetas i të cilit është ai.

Kompetenca ndërkombëtare për shpalljen e personit të zhdukur, si i vdekur , Gjyqi i R. Maqedonisë është ekskluzivisht kompetent, për shpalljen e shtetasit të zhdukur të R. Maqedonisë si të vdekur, pa dallim se ku e ka pasur vendbanimin. Para gjyqit të R. Maqedonisë mundet që sipas të drejtës së R. Maqedonisë, të konfirmohet vdekja e shtetasit të huaj që ka vdekur në territorin e R. Maqedonisë.

Dispozita të tjera për procedurën me element ndërkombëtar

Aftësia e të huajit dhe ndërgjyqësore e personit fizik, për aftësinë e të huajit dhe ndërgjyqësor të personit fizik, kompetente është e drejta e shtetit, shtetas i të cilit është ai.

Nëse shtetasi i huaj nuk është i aftë për ndërgjyqësi sipas dispozitës të këtij ligji, ndërsa është i aftë për ndërgjyqësi sipas të drejtës së R. Maqedonisë , vet mund të ndërmarrë veprime në procedurë.

Litispendenca e huaj, Gjyqi i R. Maqedonisë me kërkesën e palës do ta ndërpresë procedurën, nëse rrjedh procesi gjyqësor para gjyqit të huaj, në punën e njëjtë juridike dhe ndërmjet palëve të njëjta, dhe nëse :

- 1) Së pari para gjyqit të huaj është ngritur procesi gjyqësor i marrëdhënies, për kontestin e marrëdhënies;
- 2) Në pyetje është kontesti, për gjykimin e të cilit nuk ekziston kompetenca ekskluzive e gjyqit të R. Maqedonisë.

3) Vlerësimi i kompetencës së gjyqit të Republikës së Maqedonisë

Për vlerësimin e kompetencës së gjyqit të R. Maqedonisë, me rëndësi janë faktet që ekzistojnë në kohën kur procesi gjyqësor fillon të rrjedhë.

Obligimi për sigurimin e shpenzimeve të gjykimit (cautio iudicatum solvi), Kur shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi që nuk ka vendbanim në R. Maqedonisë, ngrit proces gjyqësor para gjyqit të R. Maqedonisë, është i obliguar që të paditurit i cili është shtetas i R. Maqedonisë, me kërkesën e tij t'ia sigurojë shpenzimet e gjykimit. Sigurimi i shpenzimeve të gjykimit jepet me para, por gjyqi mund të lejojë që sigurimi të jepet edhe në mënyrë tjetër.

Lirimi nga obligimi për sigurimin e shpenzimeve të gjykimit, i padituri nuk ka të drejtë për sigurimin e shpenzimeve të gjykimit, nëse :

- 1) Në shtetin shtetas i të cilit është paditësi, shtetasit e R. Maqedonisë nuk janë të obliguar që ta japin sigurimin;
- 2) Paditësi e gëzon të drejtën e azilit në R. Maqedonisë;
- 3) Kërkesa e padisë ka të bëjë me kërkesën e paditësit, nga marrëdhënia e tij e punës në R. Maqedonisë;
- 4) Është në pyetje padia për kambial ose çek, kundërpadia ose lëshimi i urdhërpagesës.

Lirimi nga pagesa e shpenzimeve të gjykimit, Shtetasit e huaj kanë të drejtë për lirimin nga pagesa e shpenzimeve të gjykimit, me kushte të reciprocitetit. Në raste të dyshimit për ekzistimin e reciprocitetit, lidhur me lirimin nga pagesa e shpenzimeve të gjykimit, sqarim jep organi i administratës shtetërore kompetente për punët e drejtësisë. Personi pa shtetësi ka të drejtë për lirimin nga pagesa e shpenzimeve të gjykimit, nëse ka vendbanim ose vendqëndrim në R. Maqedonisë.

Pranimi i vendimeve të huaja gjyqësore

1. Si vendim gjyqësor i huaj, konsiderohet vendimi i gjyqit të shtetit të huaj.

2. Si vendim gjyqësor i huaj, sipas këtij ligji, konsiderohet edhe barazimi i lidhur në gjyq (barazimi gjyqësor).

3. Si vendim i huaj gjyqësor konsiderohet edhe vendimi i organit tjetër, që në shtetin ku është marrë, është barazuar me vendimin gjyqësor, përkatsisht barazimin gjyqësor, nëse me atë rregullohen marrëdhëniet e parapara me këtë ligj.

Pranimi, Vendimi i huaj gjyqësor barazohet me vendimin e gjyqit të R. Maqedonisë, dhe prodhon veprim juridik në R. Maqedonisë, vetëm nëse e pranon gjyqi i R. Maqedonisë.

Kompetenca ekskluzive e gjyqit të Republikës së Maqedonisë

1. Vendimi i huaj gjyqësor nuk do të pranohet, nëse në punën e marrëdhënies ekziston kompetenca ekskluzive e gjyqit, ose organit tjetër të R. Maqedonisë.

